



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË GJASHTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 29.06.2022 (e Mërkurë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, kryetari, z.Sokol Haliti, nënkryetari, z.Hasan Aliu; si dhe këshilltarët e Kuvendit: Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Zejnepe Osmani, Ali Bajrami Liridona Bislimi, Sejdi Emini, Nexhat Halili, Remzi Salihu, Durim Sylejmani, Lindita Demelezi, Majlinda Shabani, Taulant Haxhiu, Musli Neziri, Vilsona Maliqi-Salihu, Veton Ramadani, Anisë Zejnullahu, Reshat Azizi, ndërsa mungoj Taibe Ibrahim, Sokol Shaqiri, Zyrafete Rama, Ekrem Ymeri, Arbnore Hajredini, Jakup Demiri Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 21 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e gjashtë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, gjatë kësaj periudhe kemi konfirmimin e ligjshmërisë të të gjitha akteve, përveç një akti për të cilin ende nuk kemi marr konfirmim të ligjshmërisë. Para se me fillu me rendin e ditës, kërkoj që të ju përmbahemi rregullores së punës.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Po dal këtu me u përball me disa e jo me ju fol pas shpine, sepse jam i tillë që kur të flas flas përball, e përballem përball. E në këto ditët e fundit fatkeqësisht kanë qenë njëri nder ata prej njerëzve të caktuar me interesa të caktuar është laku emri im nëpër portale, në disa publik e disa të mshefta qysh janë mësu njerëzit me i bë në kohën e caktuar, edhe para luftës edhe pas luftës, për m’i arritë qëllimet e veta që i kanë. Mirëpo unë jam njëri prej atyre që njihem krenar për gjithçka që kam bë deri tani. Fatkeqësisht ka njerëz të mjerë të cilët mëshafen pas perdeve të caktuara, e fatkeqësisht që kemi edhe në kuvend këtu, që mundohet me i degradi njerëzit e ndershëm, njerëzit e moralshëm, punëtorët, e që unë jam njëri nder ata që dy mandate i gëzoj besimin e qytetarëve të jem këtu në kuvendin komunal. E kuvendi komunal është adresa ku qytetari më së miri e merr besimin edhe vlerësimin e tij. Unë edhe disa jemi që dy mandate, njihem krenar, shumë krenar me baballarët, shokët, kolektivin ku punoj, sepse ata na njohin më së miri, mirëpo prap po e thamë, një ditë, shumë frik ndoshta do të dal edhe me emra publik për këta njerëz të mjerë të cilët po fshehën, e që mendoj që janë tu degradi në çdo aspekt, do të përballem me ta, sepse jam i tillë që përballem me ta. Njëherë e kam bë një gabim që kam dal atë ditë, ditën e betimit, që e kemi bë betimin. Nëse kam bë shkelje ajo ka qenë.

Kuvendi është organi me i lartë komunal, nuk është mirë me degradu kuvendin, nuk lejoj me fol pas shpinës, sepse jam një njeri familjar, me master, i kam tre mandate në kuvend, nuk lejoj me ndodh këto sene.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Është e moralshëm me e respektu seci secilin.

znj.Majlinda Shabani: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Komiteti për Arsim, Rini, Kulturë e Sport e kemi bënë një plan të punës, e ku kemi parapa vizita, e që i kemi bënë në disa shkolla të Vitisë, e një problem që është shumë serioz, e që duhet mu marr me atë konkretisht është me bënë një komision, i cili kish me i mënjanu inventarin e vjetër të shkollave, sepse ka shumë inventar të vjetër, e duhet mu asgjesu ai inventar, sepse po e zen hapësirën. Kemi vërejt edhe një problem tjetër tek infrastruktura e shkollave, sepse secila shkollë i ka specifikat e veta. Shkolla në fshatin Lubishtë, ku ka problem serioz, pikërisht me piken në shkollë, me kulmin e shkollës, edhe që mendoj që duhet me u marr pikërisht me këtë, sepse ndikon në shëndetin e fëmijve. Edhe një problem tjetër është pikërisht te banesa, është pikërisht rrugës së komunës, është podrumi i cili ka problem me ujërat e zeza dhe mbeturinat, e që qytetarët kanë shqetësime të vazhdueshme për sa i përket këtij lloji problemi. Ju faleminderit!

z.Illir Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Majlinda i ngriti disa shqetësime, po nuk paska gjetë material për shkollën në Pozharan, Problemi i shkollës në Pozheran është se aty pas takimin të fundit, shkolla fillore ka vendos që aty ma nuk do të mbaj mësim. A ka mundësi me e ditë na, ku do të mësoj fëmija prej 1 Shtatorit? Është shumë me rëndësi me u marr me këtë çështje dhe e di saktë se me vendim të këshillit të prindërve dhe këshillit të mësuesve dhe drejtoreshës, sepse po i behet shumë dëm shkollës së mesme. Pyetjen e dytë e kam pas për drejtorin e administratës, s'qenka këtu, i kam ngrit edhe dy shqetësime të vogla. E para, për seancën e parë i kam kërku komunës për me e rregullu parkingun për punëtor që punojnë në komunë, edhe m'ka rastis domethënë gjatë kësaj jave të komuna e re, definitivisht duhet me ndërmarr, se se di qysh janë tu mujt me nejt ata punëtor aty prej aromës të ran që është mrena objektit të komunës së re. E di që kanë këqyr me bënë diçka, po zgjidhje s'kanë ba. Edhe e treta, drejtori i financave me 18 prill bashkë me drejtorin e kulturës e keni marr një vendim për klubin çiklistik "Korri", një subvencion që me organizu shkuarjen në Koshare, e sot është 28 Qershori mjetet nuk janë dal ende.

z.Taulant Haxhiu Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë i kam dy pyetje. Pytjen e parë e kam i nderuar nënkryetar, projekti i rrugës së shpites së kulturës ka afër 1 vit e gjysmë. Me sa duket edhe aty banesa ende nuk ka perfundu, e kam fjalën mas shpites së kulturës e deri afër pasqyrës, të kjo dalja. Pytjen e dytë e kam ardhjen e mergimtareve na edimi që edhe një jave dite kemi me pas një fluks të jashtëzakonshëm të mergimtareve të tona un kerkoje nga qeverisja lokale të rritet nevoja në shërbime si furnizim me ujë largimin e mbeturinave dhe shërbimet e tjera administrative andaj ne e kemi një mbështetje apo një infuzion mergimtare duhet të jemi sa me të mobilizuar që ata pushimet verore të i kalojnë sa më mirë në komunën të tona. Kjo është për dy partneret e koalicionit, edhe Partisë Demokratike edhe Lidhjes Demokratike. Pytjet e 3-të e kam për z.Besnikun, drejtorin e financave. Zotri Besnik, është hera e 3-të që unë do t'i kërkoj kontratat në vepra, që t'i sjellësh me emër mbiemër, kush janë ata, ta dinë qytetarët, është mirë së paku me ma dhanë këtë përgjigje, po ti as përgjigje. Këtë përgjigje e du nga ti zotri drejtor. Ma herët drejtori i kaluar që është prezent këtu, m'i ka sjell pasiguri që jeni në koalicion e keni për obligim ndaj qytetarit të komunës të tona.

znj.Majlinda Shabani: Faleminderit kryesues! Meqenëse mu permen emri për sa i përket shkollës së Pozheranit, kam informacione të mjaftueshme, mirëpo shkolla e Pozheranit është njëra prej problemeve, çështjeve e cila duhet me pas si rend të ditës me diksuti në kuvend. Jem kan e kem vizitu, e dim numrin e nxesave

jan dikun 462 sa klasa jan msimi zhvillohet me 3 ndrrime. Tani po e dimë qe shkolla e ozheranit ndrimtimi i tij ka fillu qysh prej vitit 2016 i dim edhe takimet qe i kemi mbajt me drejtoreshën ministren deputetin qe e kemi pas prezent kshtu qe e dim edhe ashtu se ku eshte problemi por meqë eshte mir mi informu qytetaret edhe me qen sa ma transparent nuk po du me marr fjalën me zgjat per shkollën e Pozheranit, zgjidhja është kjo, ne si Komunë e Vitisë, meqenëse nuk mujm me i bë zgjidhje momentale, domethanë për sa i përket objektit të shkollës duhet me be një zgjidhje, me ba bartjen e nxensave në shkollë të Vitisë, me be nje sigurim transoporti prej anës komunës, iu kish mundësuar nxënësve me viju msimin, se është problem shumë i madh, edhe qe nuk mujn me vazhdu. Domethanë me viju mësimin në atë mënyrë.

z.Bekim Azizi, kryesuesi i Kuvendit: Besoj qe te zgjidhja duhet te punohet drejtoria e arsimit qe do e jep një zgjidhje.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje për gjithë të pranishmit! Atëherë unë dua te diskotoj mes disa problematikave dhe shqetësimeve qe jan mes qytetareve tanë se pari po e filloj me temën ne mes mirmbatjes se varrezave te deshmoreve ne qytetin e vitise besoj qe te githe jemi te pajtimit qe per varrezat e qytetit eshte nevojt e caktohet nje punëtori e veqeant mirembajtje dhe jo vetëm njejt edhe tek trotuaret tek sheshi Njazi Azemi ai i Rashit Mustafes Safet Rexhepit Baftu Haxhiut pasi qe si institucion kjo besoj qe eshte e pakta qe do duhej bere per kontributin e tyre karshi neve ata qe dje nuk kursyen as jetën e tyre qe ne ta gzojm sot kete liri dhe ndajm kete kuvend sot fal gjakut te tyre ne aktualisht sot besoj qe nuk duhet te kursejm asgjë e aq me pak ato qe ceka me larte komuna duhet te mar bashk nje debat publik dhe si sygjerim apo iformacion nga komuna e kaqanikut me eshte thene se nga viti i kaluar ata i postojn edhe ne faqet zyrtare pytjet qe qytetarit i ofroj ngjat debateve publike ato te cilat i jan kthyer pergjigje dhe ato te cilat kan mbetur pa i përfunduar pergjigjet eshte mire qe nje praktike e tille do duhet te fillonte tash e tutje te zbatohet edhe tek ne pasi qe besoj qe kjo do te ndihmonte edhe ne transparencën te qeverisjes lokale kam nje pyetje konkrete per drejtorin e arsimit drejtoresha a zhvilloni takime me drejtorin e shkollave te komunës se vitise dhe ambani dikutime dhe raportime per sjelljet e tyre dhe kush jan përgjegjësit nese nje drejtor nuk e lejon hapësirën e shkollës të shfrytëzohen nga këshilli i fshatit per aktivitete të tyre nje raste i tille ka ndodhur ne shkollën e fshatit lubishte pra hapsira shkollore mbrenda objektit nuk iu eshte leju këshillit te fshatit dhe familjareve te kolonelit Rashit Mustafa pa ia ofruar ndonjë aryse ta mbajn takimin jasht objektit shkollor ne e dim qe eshte obiligim institucional dhe qe ne raste te tilla shum pak prova ju duhen kush qendrona mbrapa ktij vendimi qe përfaqësuesit e fshatit dhe familjaret ky vendim realisht ngjalli **pakënaqësi** plani i mobiliteti komunal ka qen i parapare per vitin 2016/2022 eshte raport edhe pse i ka kalu afati i tije na intereson ta dimi si informacion sepse ka mjaft reagime te cilat jan te pa përfunduara nplan dhe nese komuna ka marr ndonjë mundësi te veprojt rreth kësaj teme jemi ne muajin qershor pra i cili hym ne sezonin e veres dhe siq e dim ne kete kohe komuna e ka per obligim ta bej mbikëqyrjen e rrugëve dhe trotuareve neper lokalitet tona banoret e fshatrave te ndryshëm e sidomos ata te vendeve rurale e kane filluar mbulimin e trotuareve dhe rrugës kryesore nga bari i madhe kur do te filloni ta trajtoni kete problem aktual .

z.Musli Neziri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Fillimisht pytjen e parë e kam, meqense në mungesë të drejtorit te sherbimive publike, të cilit i urojmë shëndet, se e dimë rastin e tij, dje nënkryetar do të ua shtroj pyetjen juve. Dje keni pas një takim me drejtorin e Eko higjienës dhe Senad Ramaj, më vjen mirë që e pash atë takim, po dashta me të bë pyetje, se a eshte bisedu dicka rreth njoftimit qe ju ka ardh veteraneve të luftës, se nga muaji korrik do te hyn në pagesë te mbeturinave, andaj unë e mora njoftimin këtu, të cilin ja u kanë dërgu ata atyne kategorisë së luftës, sepse aty thotë kshtu: tashmë janë bërë më shumë se 20 vjet kohë që keni luftuar për

pavarësinë e vendit, të Republikës së Kosovës dhe kejt këtë të cilën po e citoj, të jep me kuptu se veteranët e luftës trajtohen sot që ju del afati për ndërtimin e këtij vendi, duke e pas parasysh në pjesën e tyre që kanë thanë se nga 2008 nuk kanë marrë për këto kategori, se i paskan lëshu edhe 54 mijë euro në buxhetin e kompanisë publike private. Ne e dimë që ajo kompani nuk operon ndoshta kejt në fuqinë e komunës sonë, por kisha pas një kërkesë, kjo kategori të mbulohet nga pjesa e komunës ose të gjendet një modalitet, se kategorinë e veteranëve të luftës të jenë të liruar. Pra, nga kjo të lirohen nga pagesa të cilën ata e kanë paralajmëruar që do ta kenë në korrik, Pyetja e dytë shkon për drejtoreshën e arsimit. Drejtoresh, nëse ka mundësi me na tregu se, si bëhen transferet e msimdhënsve, sepse në disa shkolla janë lejuar dhe në disa jo, prandaj të gjithë mësuesit operojnë nën një ombrellë të Drejtorisë së Arsimit. Tu kisha lutur për një përgjigje, kur lejohet dhe kur nuk lejohet. Dhe e treta, meqenëse kolegët parafolësit e mi, e thyen, jam i prirur me i respektu dy pyetje ashtu me rregullore. Po meqenëse e thyen parameje, atëherë i bëj edhe unë me kërkim falje. Kryesues, në rrugën “Kemajl Azizi”, konkretisht rruga e Ramishtes, aty ka problem ndriqimi publik. Prap me lidhet pyetja me drejtorin e shërbimeve publike, mundësisht në kuadër të saj të dilet të shikohet vendi. Një kërkesë e një familje aty, që ka të sëmuar dy fëmijë e që i vijnë me hec me karroca, andaj mundësisht aty të ketë parasysh, të rregullohet me ndriqim dhe realisht ai ndryshim një fushë bënë tri, s’bëjnë, pra komplet atë rrugë. Mundësisht të bëhet ndërhyrja për shkak se është një kërkesë e familjes për kushtet që i ka.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pyetjen time ja kisha drejtuar rreth kontratës kolektive. Është një pyetje që shkon për Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e Shëndetësisë nënshkruar do të je Komuna e Vitisë. Sa është shuma në mes këtyre drejtorive që paguan për këta punëtor që e bëjnë. Dhe pyetjen tjetër e kam për drejtorin e inspeksionit. Dim që tashti fillon edhe fluksi i ardhjeve të mërgimtarëve. Cka u bë në këtë drejtim rreth organizimit sa më të mirë për largimin mbeturinave, se është problematikë që po na përcjell çdo vit.

z.Nexhat Halili: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kam dy pyetje. Pyetja e parë ka të bëjë me çështjen e kontratave dyvjeçare dhe trivjeçare. Cilat hapa janë të cilat i ka marrë komuna jonë. Në këtë drejtim komuna jonë na ka dhënë një regjistër të gjithë këtyre kontratave në këtë regjistër konsultohet niveli qendror. Se si të veprohet në këto kontrata, sa e dimë na tash lëvizja e cmimeve është enorme dhe operatorët ekonomik me siguri se do të neglizhojnë kryerjen e punëve në kuadër të këtyre kontratave hynë edhe rruga Sllatinë Viti dhe trotuari i cili i lidh tri fshatra, Trestenikun, Sodovinën dhe Sllatinën. Pyetja e dytë ka të bëjë me rregullimin e rrugëve në Komunën e Vitisë shoh se Komuna e Vitisë ka inicuar procedurën për rregullimin e rrugëve me zhvorr për komunën tonë nuk e di unë arsye pse ka fillu kjo procedurë e prokurimit, kur kjo kontrata e lidhur vitin e kaluar ka afat edhe një kohë e cila e mbulon një kohë të gjatë. Nuk e di unë arsye, kjo kontratë kjo procedurë e prokurimit vec është stopu për momentin. Unë nuk i di arsyet pse është stopu, pyes: pse është vepru në këtë mënyrë

znj.Lindita Demelezi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam disa pyetje në lidhje me disa çështje për drejtorinë përkatëse. Materiali shpenzues në shkollat e fshatit Pozheran dhe Sllatinë e Poshtme, mungon sanitarja e mëposhtme, do të thotë mungojnë gjërat elementare. Kërkoj nga Drejtoria e Arsimit të na raportoj me shkrim për secilën shkollë për shpenzimin e materialeve shpenzuese gjatë muajve të fundit dhe nga drejtoria e sekretariatit një raport për gjendjen aktuale sanitare në shkollat, sidomos ujit të pijshëm dhe tualeteve, meqenëse ka shumë shkolla kërkojmë të raportohet në seancën e radhës për shkollën që ka numër më të madh të nxënësve Pozheran, Viti, Smirë, “Dëshmoret e 5 Prillit”, skifteraj “Kenan Halimi”, dhe Sllatinë “Nijazi Rexhepi” dhe të na dërgojnë materialin paraprakisht që ka mu diskutu në seancë. Lutemi që sa më parë të përgatitemi për fillimin

e vitit shkollor. Pyetja e dytë, Këshilli i Fshatit Sllatinë e Poshtme ka bërë kërkesë për ndriçimin publik të rrugës kryesore për gjatë rrugës Sllatinë e Poshtme në drejtimin e Pozheranit, gjë që vetëm gjysma e fshatit është ndriçuar, e cila frekuentohet shumë nga nxënësit dhe banorët. Kërkesa është bërë me 17.09.2020, me numër të protokollit **09-884/30257**, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Ju lutem, ku ka mbetur kjo kërkesë e pashikuar.

z.Reshat Azizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Është e njëjta pyetje që 5 muaj që e shtroj. Kemi problem me Komitetin për Komunitete me përkthyes. Prapë mungon përgjigja, e njëjtë është, nuk e di deri ku ka marrë procesi në vijim. Kam edhe një shqetësim tjetër, që lidhet me komunitetin për komunitete, kemi problem me kuorumin në mungon një pjesëtar i komuniteti ashkali, aty i figuron vetëm emri, kurrë nuk ka marrë pjesë. A ekziston mundësia të zëvendësohet ai person ose si janë procedurat.

z.Basri Sylejmani: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë i kisha pas dy pyetje, po masë pari për me mbajtë rendin e ditës, në çoftëse i bëjmë dy pyetje i bëjmë dy, pyetje në çoftëse e bëjmë krejt po ja nisem po folëm krejt, se unë i kam veç dy pyetje. Është hera e tretë që e potencoj semaforin në Viti, që është shej, është thy. Unë s'jam tu ditë kush është përgjegjës i asaj. E pyeti drejtorin, ky thotë, unë se kam për detyrë, i pyeti ata tjetër, as ata se kanë këtë detyrë. Unë kisha pas dëshirë ata vet me i largu dhe me i vendos ku është sheji i asaj pllakës aty, ku a reklama. Dhe pyetjen e dytë, masë s'është drejtori i shërbimeve publike, po nënkryetari është. Rruga "Gursel Sylejmani dhe Bajram Sylejmani", që dy vjet që keni investuar rrugës, është e bllokume ara. Janë 20/30 hektar, ajo ka pas mu shtru me zhavorr. Edhe kaq kisha unë.

znj.Zenjepe Osmani: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sot kam dy kërkesa. Siç po shihet ka kërkesa më së shumti për shkollë, kam kërkesën për shkollën fillore të mesme të ulët, paralelja në fshatin Drobesh. Kjo kërkesë me ka ardh nga këshilli i prindërve, që kjo shkollë të jetë një shkollë manuale si shkollat tjera, se në këtë shkollë si dihet është numri i nxënësve. Kemi shifra mbi 300 nxënës, edhe kështu që kërkojmë nga organet përgjegjëse që të merrni me përgjegjësinë më të madhe. Kërkesa tjetër është po e njëjta për këte shkollë, edhe një ndihmë, punëtorët për mirëmbajtjen e kësaj shkolle, se tash ajo shkollë dihet që është me një kapacitet shumë të madh, edhe nuk ka mundësi që krejt shkollën ta mirëmban vetëm një punëtor. Kështu që edhe kjo kërkesë është nga këshilli i prindërve dhe që kjo ndihmë të jetë.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kam dy pyetje, nuk do e zgjas shumë, për drejtorin dhe nënkryetarin, pasi që kryetari s'është për ujësjellësin e fshatit Remnik. A është buxheti i këtij viti, ujësjellësi i fshatit Remnik dhe nga këtu pra shihet nëse është një pjesë në këtë fshat. E dyta, pyetja do të ishte për kryetarin, po masë është nënkryetari, kisha mujt me bisedu, nëse jo, atëherë kur të vjen e sqaroj. Nuk e pata ndërmend ta them këtë, po u cek kontrata kolektive dhe e dimë fort mirë të gjithë se këtë kontratë kolektive mes grupit të Lëvizjes Vetëvendosje, disa herë e kemi ngrit këtë çështje në kuvendin komunal, disa herë i kemi dërgu kryetarit aktual, që njërin vesh për zbatimin e kësaj kontrate dhe të ja bëjmë disi, po ai s'ka dashtë me dëgju për këtë punë fare, duke u arsyetuar, se kontrata kolektive është bërë pa prezencën e komunës. Në rregull që kështu ka qenë, po pyetja për nënkryetarin shkon: pse zotëri kryetar nuk e ke paditë Avdullah Hotin, domethanë Qeverinë Hoti, ku pikërisht në atë qeveri është bërë kontrata kolektive dhe ekzekutimi i atyre gjobave nga gjykatat në territorin e Kosovës, po tashti po paditë Qeverinë Kurti

z.Sejdi Emini: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë dua ta ngris një shqetësim të banoreve të fshatit Goshicë. Trotuari në Goshicë ka një kohë që ka fillu e që njihet që ka fillu, se ka qenë nevojë e kamotshme për sigurinë e këmbësorit, mirëpo punimet të cilat janë tu zhvillu aty, janë tu zhvillu qaq kadal, sa që nuk e di qysh mundet ma kadal me shku. Është mirë me ju ba presion kompanisë, e cila është tu i kry punët, sepse vazhdimisht bënë pengesa me një bager në rrugë aty. Tash vinë edhe mërgimtarët, ka me pas pengesa në komunikacion, është

mirë që me gut atë proces me kry pak ma normale, jo një ditë, me ardh dy ditë mos me ardh një javë, mos me ardh, po paraqet pengesa edhe për banorët.

z.Bekim Azizi, kryesuesi i Kuvendit: Besoj që të gjithë që kërkuat fjalën ja u kemi dhënë. Keni bërë pyetjet që ju falënderoj shumë pyetje përgjegjësi në jetën e përgjithshme për brengat e qytetareve. Unë po mendoj drejtorët të ju përgjigjen.

z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës: Përshëndetje të pranishëm! Unë do të bëjë përpjekje me u përgjigj ato të cilët me të vërtet kam informacion të plote dhe për ato të cilët kanë mendim ndryshe do ta shprehim edhe vet tu fillu kështu për Sejdies të cilit u drejtu fillimisht shumtën e rasteve e kuptova megjithatë duhet me kuptu këshilltarët se jetojnë në shekullin XXI, jetojnë në Viti, duhet me u përball edhe me ato çështje, po megjithatë unë besoj që ligji është ai i cili kërkon këto çështje pasive, besoj që ka me e formu këshilltarja një komision që do të jet një ankand publik dhe në mesin e tyre që edhe ata me pa dikush që është i interesum. Unë besoj që drejtoresha do ta ka parasysh këtë pyetje dhe dytë të Lubishtes, rreth shkollës të banesa e verdh. Çështja është se ka me një banesë e cila asnjë pronar nuk e ka aty ekzistues, pronar legjitim që i ka letrat e rregullime dhe mandej që e din kohën e ndërimit, është ndërtua, për çka ka me kështu si është edhe pse në shumë herë kemi intervenu aty, por mirëmbajtja mungon. Ajo mirëmbajtja e sinqertë të cilën mund ta themi. Ilir, do të lidhna edhe tek ti edhe tek Majlinda, se mu po më vjen një shenjë replike e bëri edhe një propozim i cili mu nuk më pëlqej hiq. Nuk kemi nevojë mi bart nxansat për regjion të Vitisë. Këshilltarëve po ju them edhe një herë juve gjithë këshilltarëve, tu fillu prej kryetarit dhe kryesuesit. Në këtë rast tu ju drejtu juve pak ma shumë për shkak të nuk jam idhtar i asaj po megjithatë e ke një kryeministër dhe e ke një ministër të njëjtës familje politike dhe ndikimi. Nuk duhet të krijojmë në alternativë për me i bart nxënësit e Pozheranit me i pru në Viti, po duhet të insistojmë, që shkolla Pozheranit të përfundoj dhe nxënësit të kthehen në shkollë funksionale, prandaj do të ishte kjo shumë me e pranueshme e di që në komune është intervenu kam pas informacion që është rregullu ajo çështje dhe ndërkryesit edhe ta shoh gjendjen qysh është. Projekti pas shtëpisë së kulturës do të fillon se shpejti grandë i performances veç u kry edhe e kemi projektuar edhe do ta trajtojmë ardhja e mërgimtarëve. Kemi bërë përpjekje maksimale, kemi shtu shërbime në shërbimin e punëtorisë do t'i shtojmë të zjarrfikësata për shkak se po himë në muajin e nxehtë të Verës dhe ajo që u kanë nga ana e jonë dje kanë pas takim me drejtorin e Ekohigjenes edhe pse të them të drejtën kështu kjo e jonja veç 49 % - 59% të atij edhe 49 me Gilan, Kamenicë, Novoberdë 13% është ajo, por atë 13% me shfrytëzua maksimalisht kam kërku nga ana e tij, që mjetet transportuese të mbeturinave nuk janë mjaftueshëm. Në rast se ka nevojë shtim të kapaciteteve dhe punëtorëve, i kanë premtu se në Pozheran edhe komuna jem në gjendje me mbaru një ditë, por megjithatë masi ka nevojë me i shtu kapacitetet 24 orë punë, sidomos në kohën, të cilën vitin e kaluar kemi pas telashe të mëdhaja, është zotu edhe ai që do të bëjë përpjekjen. Ka siguru që i ka 40 mjete të cilat operojnë në Komunën e Vitisë. I kena paraqit kështu problematikat të cilat hynë përmes mjeteve të informimit. Gjithmonë e kam thanë se, shumica e këtyre që ankohen nuk janë të regjistruar për kryerjen e shërbimeve. Që kanë bërë një pyetje për këta mërgimtarët që vinë përkohësisht për dy muaj me shku me i pagu edhe me kry punën e shërbimeve edhe e 3 kishte disa probleme në disa lagje të cilat e bajn problematik kamioni me hy edhe mu sill. Një prej saj e kam vizitu edhe unë, ishte problematik të cilin një fshat për pajisje tjera. Tash është kërku me qenë një vend caktim nga banorët e lagjes, një kolektiv edhe me shku kështu numri. Ajo të cilin e shpreh këshilltari, konsideroj se atë çështje e rregullon ligji, se gjithçka konfirmim ligjit duhet të funksionojmë edhe në edhe kompania transferon. Unë veç ja kam dhanë

n'konfrom ligjit. Në rast se ligji i liron këtu, nuk kem çka bisedojmë a i vinë paret prej komunës a prej qeverisë, është çështje e kompanisë. Ligji nëse e ka rregullu këtë çështje, unë besoj që ligji është më i madh se komuna, se vet "Ekohigjena" dhe ky segment punon në përputhje me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Liridon, me ty se di a i kemi qasjet e ndryshme a s'jem tu kuptu, se unë nuk pajtona bash hiq, n'Veçanti te folklorizmi i tepruar edhe fillimi i keqpërdorimit të figurave të lavdishme të komunës tonë, shtetit tonë. I ngrit varrezat e dëshmorëve ndaj pastërtisë, sheshi "Njazi Azemi" vendi i parë, sheshi "Rashit Mustafa" vendi i parë, sheshi "Bafti Haxhiu" vendi i parë. Dhe këtu nuk pajtona që e ngriti këtë çështje, kur na i kemi pa punëtorë bashkë me njerëzit që janë bashkëpunëtor të qytetit, i pastrojnë hapësirat publike dhe kontrata e tyre ekziston. Tash e ke be një pyetje a zhvillohet takimi. Me drejtor zhvillohet. A ka që lejohen hapësirat, po këta e kemi ne kontratë. Unë kam qenë edhe ne ditën e shkollës në Lubishtë, kam qenë edhe ditën e ramjes së komandat Karadakut që e njohim vetëm si dëshmor që kam obligim personal. Po e thamë edhe publikisht, se fati ka qenë qashtu që kanë qenë ushtar në ish Jugosllavi në terren edhe i kanë obligim për tanë jetën deri sa të ekzistoj. Shpresoj që gjithçka ka qenë plani i mobilitetit. N'rast se në këtë legjislaturë ne duhet të përgatitim për çfarëdo ndryshimi rrugët me parolla nuk paske dal me i shiku se tu kosit, konsiderohet se me "Ekohigjienën" veç e morre përgjigjen, transferet janë. Te rruga "Kemajl Azizi" problem ndriçimi publik. Pas takimit më nuk do te jemi ata te cilët e përcjellin, por do t'ja sugjerojmë me ardh dhe me shiku, nuk e di sa është shuma zotëri e lidhjes nga kontrata kolektive, por megjithatë një çështje e di, se e përmendi edhe Remziu, gjithçka që është ba në Kosovën tonë pa koordinim të plotë kanë qenë pasojat, dhe konsideroj se edhe kjo kontratë për gabimin e mbeturinave. Besoj se ishte përgjigja që mjafton. Kontratë 2 vjeçare. Regjistrin do ta kesh, nuk është problem, muj me nxjerr tash nuk e kam, por seancën e ardhshme besoj se ki me pas dhe kem pas kontrata dyvjeçare për rrugë me zhavorr dhe e kemi qit, dhe pse është stopu çështje e dhënies së ofertuesve, është pagesa. Ti e din jo vetëm ata, po gjithë tenderët që kemi pas ankesë, qashtu më kanë informu edhe deri sa te shqyrtona kërkesa e këshilltarit, 1 këshill i fshatit mun me ba kërkesa pandërpre, por megjithatë duhet të jet në përputhje me agjendën e kryetarit dhe strategjinë e kryetarit. Unë besoj që edhe ndriçimi publik nuk është shumë me konstatimin e juve, përndryshe e kem mundësinë edhe na se është prioritet. Në krahasim me kualitetin nuk e kanë sasinë. Ata të tjerët e kanë ba një intervenim të vogël sa i përket përkthimit. Dhe Reshat, Komuniteti për Komunitete lajmëroresh bash po me vjen brengosese, pse këtë nuk e paska thanë këtë çështje. Ai bisedon me kryesuesin, zëvendësimi tash shkon në konfrom me ligjin edhe besoj që pas tjerëve shumicën e pyetjeve ka ana e Drejtorisë së Shërbimeve publike se edhe çështja e samaforave vjen aty, megjithatë duhet me shiku mundësinë me rregullua. Ka nevojë shtrurja me zhavorr nëse ka qenë e parapamë te "Gursel e Bajram Sylejmani", besoj kur të fillon tash këti, mandati ka me u ba Zejnepe. Për të dytën po ta la për punëtoreshën ndihmese, e kemi drejtoreshën përndryshe ndiqe udhëzimin administrativ në rast se i plotëson kriteret edhe kohën duhet me zan afatin, pse mos me marrë një iniciativë, po në rast se s'i plotëson duhet si kërkesë me u refuzu bashkëvendës i imi. Sa i përket ujësjellësit në Remnik, jo vetëm në komunitet brenda lokaliteteve të cilët kanë qenë shkruar të marrëveshjes se nuk po thamë që na ka dështu, po i vjen era. Unë e di që e kam bekimin e plotë edhe nga ana juve, edhe ka qenë gatishmëria juaj, megjithatë në atë marrëveshje e cila ka qenë kryetari i komunës, së drejtorisë Anamoraves në krye me drejtorin. Unë veç sa po u informova që e kane shkatrru drejtorin, e gjete të tanishëm dhe megjithatë ato çështje nuk na kanë shku mar e mirë. Në qato 13 lokalitete ka qenë i parapam edhe Remniki. Sa i përket punimit të ujit, gjithherë kam bisedu se duhet te ndërtohet një burim aty brenda lokalitetit nuk ka qenë e parapamë me Letnicë, se pe di që ka qenë e parapamë me ligj jo kontrata kolektive zbatimi i saj dhe pse se ka paditë Avdullah Hotin. Me paditë

edhe Avdullah Hotin e Hashim Thaçin e Albin Kurtin, cilin dush tash e kom për vendin tonë, na jem institucione komunale, domethënë nënshkruesi saj ka qenë në atë kohë kryeministri Hashim Thaçi ka fillu me u zbatu te Avdullah Hoti ka me u zbatu edhe te Albin Kurti. Po këto si nënkryetar komune të gjitha po du me ti ba ngarkesë për kryetarin e kuvendit. Një çështje të cilën pa prezencën time e banë, duhesh me i parapa edhe mbledhjet, edhe unë ndihem i krenum se nuk e kam problem, se buxhetin ju shikone sot e keni, po domethënë kerkun nuk kanë parapa mjete edhe ne realizim se ata nuk ka per krejt. Neve këtu e dimë detalisht kur dalem në pension, se kanë regjistra shumë. Në mënyrë kompjuterike për dy tri ditë për krejt komuna në zëra edhe e shef edhe provojen e punës qe e kanë. Kam pas takim progresi, Sejda e shtroj. Sejd, nuk po du me ta thanë fjalorin tim dhe të kryetarit, po mun Hafizin me pyet çfarë problemi është tu ba qe me te vërtet është tu shku kadale për detaje Zhiti Ballancë e kanë nis në Goshicë, e kanë nis në Kabash edhe i kam thanë pse po shkon me punu prej një vendi në vendin tjetër, përfundoje qeta, dil te tjera. Tash ata e shpjegojnë atë shpjegimin me vet tjetër ekip qe shkon gërryen e tjetër te kockat, tjetër anësor. Megjithatë kemi insistu, kemi pas takim, ka qenë një prej takimeve me të pastra të konsiderohet.

znj.Fatbardha Emimi: Përshëndetje te nderuar te pranishëm! M'i parashtruat disa pyetje. Një pjese duhet me u përgjigj nënkryetari, aty ku mendoj qe duhet të plotësohet natyrisht qe do t'i përgjigjem edhe në takimin e fundit qe e kisha me Komunitetin për Arsim me thanë për këtë çështjen e inventarit me 2019 ish ba një shkarkim i inventarit dhe ju tregova arsye deri me tani ka qenë arsye ligjore dhe nuk mundet shkolla me u shkarku pa i ndjek procedurat dhe duhet procedurë e shkarkimit e komisionit dhe masandej një ankandi në anë te komunës, sepse jo vetëm shkolla por edhe institucionet tjera që kanë inventar janë jashtë funksionit, po dihet që shkolla është shumë ma shpesh për shkak te karrikave dhe bankave qe dëmtohen. Këtë çështje do ta adresojna edhe besoj qe do ta zgjedhmi natyrisht, sepse është qe na preokupon edhe neve si drejtori. Shkolla e Pozheranit u diskutu shumë, është diskutu jashtëzakonisht shumë, edhe dje ju kam drejtu ministrave me një kërkesë pas takimit qe kisha edhe me komunitetin dhe këshillin e fshatit edhe këshillin drejtues te shkollës me ftesë të institucioneve komunale. Vetëm po ja baj hallin njani tjetrit edhe asnjë mundësi ligjore nuk keni, vetëm kërkoj edhe nga ju si anëtar të kuvendit, për arsye se nuk duhet po e shof qe disa anëtarë të kuvendit po e ngrisin çështjet e interesit. Ne si institucione nuk ja len veprën jemi ti informu personalisht se te gjitha shkollat janë një, po si sfidë konsideroj jo vetëm Pozherani po krejt Komuna e Vitisë e kem shkollën e Pozheranit, kështu që duhet të jemi bashkë pa dallime politike apo i gjërave tjera që bashkërisht ka me kry takim me dy ministrat, ministrin e arsimit dhe ministrin e punëve të brendshme dhe kryetarin e komunës. Ne nuk duhet me shtru edhe një çështje si opsion tjetër ne parimisht duhet te insistojmë shumë se i kemi edhe 2 muaj kohe qe ta finalizojmë shkollën e re edhe pastaj profesionet tjera qe mujna me i ba shumë shpejt. Nuk po du me menu njëherë për opsionin e B pa e qu deri ne fund opsionin A, qe duhet me nal rrjetin e tërë shkollës. Natyrisht që majm takime me drejtorët e shkollave, takime të rregullta dhe takime individuale dhe kontakte të kohëpaskohshme, e konsideroj qe nuk jam e informuar për këtë çështje Liridon, konsideroj qe drejtori i Lubishtes, dorën në zemer një prej drejtove qe është jashtëzakonisht shumë bashkëpunues me një paraqitje shumë institucionale. Ne pe dimë këtë çështje, por do te sigurohem ta marr informacionin. Lidhur me këtë, siç e dini tha nënkryetari, shkolla për këtë vit ende ka fillu me u përgatit për qato, për shkak se lënda është në ankesë në OSHP. Shpresoj qe mos funksionalizimi i OSHP-së të zgjidhet, problemet ligjore qe i kanë shkaktu e sidomos në shkollat ku dihet që afatet janë të përcaktume, që gjatë pushimeve verore do të intervenohet në to, e ne ende nuk kemi kontratë të nënshkrume, edhe pse kërkesa ka ardhë si e shtrume në Zyrën e Prokurorit Publik, domethënë ne si drejtori ka qenë puna e

parë që e kemi bërë përgatitjen se viti i ri shkollor të na gjen të përgatitur. Profesori Musë e përmendi transferin e mësimdhënësve. Është e vërtetë që ma herët si drejtori kemi mujt me ardh në lëvizje, po tash me Ligjin e Zyrtarëve Publik këto kompetenca edhe Ligji për Zyrtarët Publik nuk lejon transfere për kohë të përhershme, por me dokumente të caktuar, kështu që rasti i komisionit që e kanë themeluar, në momentin kur jam ardh tani e kam pa që nuk ka bazë ligjore për transfere nga një kod në kodin tjetër, por vetëm ndonjë punësim në orën ku mbetet apo shuhet ndonjë klasë në këtu kemi pas raste ku ma herët në shkollë i kemi transferu vet kemi mëndur që është kompetencë e komunës, tani vetëm ndonjë raste ku shuhet ndonjë klasë apo nuk ka plotësi norme ndoshta kalimi nga një shkollë në shkollën tjetër do të mundet me konkuru për shkak të konkursit publik, kontratat kolektive deri më 31 prill kemi kry obligime mbi 300 mij euro me kontratë subjektive. Do të thotë janë kërkesa që kanë ardh me herët në Janar dikun rreth mbi 7 mijë euro i kemi dergu në thesar, kërkesa për paga që në janar i kanë ekzekutu, as në shkurt as në prill as në maj, thesari nuk i ekzekuton rrogat përcjellëse që janë të planifikime me buxhet. Sa për njoftim, në buxhet janë shuma përcjellëse të buxhetume dhe në si Drejtori e Arsimit çdo muaj i dërgoj vendimet për ekzekutim të pagave përcjellëse, vetëm një muaj më parë i kanë ekzekutu, ndërsa muajin tjetër asnjë pagë përcjellëse dhe për atë një mësimdhënës detyrohet të shkoj përmes procedurës gjyqësore të realizoj një të drejtë që ata e kanë në bazë të kontratës kolektive, ku nga kjo kontratë nuk janë të buxhetume me buxhetim shtesë. Sa i përket pagave jubilarë, shujta edhe për licencime që është ngarkesë edhe më e madhe për buxhetin komunal, konsideroj që pavarësisht kërkesës që ndoshta e kanë mësimdhënësit, nuk du me hi aty se si është realizu kontrata kolektive, po në gjithë dojmë me ditë, po besoj e dinë domethënë që komuna nuk ka buxhet shtesë sa i përket kontratës kolektive, komuna ka tri grande, ka grande ka grandin e përgjithshëm, grandin specifik për shëndetësi dhe arsim, që janë në bazë të numrit të nxënësve për arsim dhe grandin i përgjithshëm rreth 1 milion euro mbështetet si komune për arsim, për atë nuk duhet me fajsu këtu as komunën, as kryetarin, as askënd për shkak se është formula që na jemi në disavantazh. Sa i përket grandit specifik, Lindit, unë nuk e di kush të ka informu për sa i përket kërkesave të shkollave, të materialet higjienike, sidomos të materialet e tjera, asnjë kërkesë deri me tani nuk është refuzu dhe të gjitha shkollat kanë material të bollshëm sa i përket materialit higjienik, kështu që unë do ta kontaktoj njëherë drejtorin e shkollës dhe absolutisht e pabesueshme një çështje e tillë që shkolla të ketë mungesë të materialit higjienik, jo vetëm shkolla e Sllatinës po asnjë shkollë nuk ka mungesë të materialit higjienik. Pavarësimi i shkollës së Drobeshit, konsideroj që ka një çështje që ministria është duke i bërë udhëzimet administrative. Në jemi tu e pas edhe një vullnet për shkak se ka numër të mjaftueshëm të nxënësve dhe organizmi dhe mbikëqyrja, monitorimi sikur të jetë me e pavarur normal që është ma funksionale edhe për neve është me e lehtë, po ministria është duke ndryshu udhëzimet administrative. Sa i përket riorganizimit të shkollave, kështu që po presim deri në shtator se në çfarë moduli janë duke shku tek funksionalizimi i shkollave, pastaj do të veprojmë edhe më tutje.

z.Illir Zuka: Drejtorët e DKRS dhe drejtori i Financave nuk mu përgjigjen në pyetjet që i bëra unë për subvencionet. Pozharani jo që nuk ka higjen po nuk ka shkollë e le ma higjen. Drejtoreshë, perime në çdo seancë në po bisedojna edhe po mendoje të ndërmarim diçka bashkërisht. Ti e din, domethënë në kemi majt takim edhe si fshat që jemi. Në çdo mënyrë duhet me u kan krah neve të bëhemi bashkë krejt, sepse shkolla në Pozharan është në gjendje të mjerueshme.

z.Nexhat Halili: Përshëndetje! Kam një koment të folklorizmi i tepruar. Kjo nuk mu duket si interpretim, secili këshilltar ka të drejtë të bëjë pyetje. Nënkryetar, unë vet jam evident dhe e kam pa në dy seancat e kalume nënkryetar, keni premtu, keni premtu ju për kontratat e një regjistri të kontratave dyvjeçare dhe trevjeçare. Unë

e kam një pyetje: sa jeni ne dijani ose sa keni kontakte me nivelin qendror për ato kontrata? Se ne e dimë që çmimet kanë lëviz, a ka një hap në këtë drejtim. Dhe e dyta, rruga Sllatinë -Viti dhe dy fshatrat tjera, s' me dhavë përgjigje. Rrugët me zhavar. Nënkyetar, kontrata ekziston, ti e potencove, thave se gjërat të cilat i posedoni nuk keni te drejtë, mirëpo me sa e di një kontratë ekziston dhe ka afat për një kohë të gjatë nuk e shohë të arsyeshme me inicu procedurat tjera për qasje te njëjta.

znj.Majlinda Shabani: Meqenëse u përmend emri i shkollës së Pozheranit. Nënkyetar, ndoshta ke qaj propozimi jem, një gjë duhet me pas parasysh, që nxënësit e shkollës së Pozheranit dhe mësimdhënësit nuk duhet t'i bartin pasojat e fajin e dikujt tjetër te puna e shkollës së Pozheranit. E përmendi edhe partinë prej se cilës vina po partia prej se cilës vim ne nuk jemi ne qeverisje prej 2016, 2018, 2019. 2016 është nënshkrua memorandum, d.m.th për shkollën e Pozheranit. Iliri është i njoftum qe 2018 është liru leja prej anës së komunës. Fillimisht kemi punu me këtë proces në 2019, në qeverisje ka qenë pikërisht LDK, kryetari Avdullah Hoti, i cili nuk ka nda mjete të mjaftueshme financiare për me u përfundu kjo shkollë. Në vitin 2020 është be arsytim pikërisht për shkak te pandemisë, kështu që opsioni A dhe B, mirëpo edhe opsioni C duhet me ekzistitu ne raste të tilla. Për këtë zgjidhje për dy muaj ditë edhe drejtoresha po dhe krejt ne duhet me u be realist, që është e pamundur me u perfundu objekti shkollore. Nxansat nuk duhet me i vujt pasojat me fillu mësimin me 20 minuta qe nuk është mësim as efikas as 20 minuta, është kohë shumë e shkurtë. Kështu që na duhet me menu një zgjidhje edhe qajo zgjidhje nuk është kanë që objekti ka ngec edhe faji nuk është pikërisht prej ministrisë së tanishme, se duhet me u ba realist dhe me pranu fajin. Diçka tjetër po du me cek. Deputet te cilët janë përfaqësues të Komunës së Vitisë janë tu ba çmos dhe vazhdimisht kanë bë çmos, takime të vazhdueshme pikërisht janë var prej deputetëve të Komunës së Vitisë, në mënyrë shumë konkrete kanë asistitu dhe janë tu munu me zgjedh këtë problem, mirëpo problemi ka ngec dikun tjetër.

z.Kryesuesi, Bekim Azizi: Edhe një po ju them, që për shkollë as nuk keni qasje as nuk e dini qysh është problemi, as nuk e dini qysh janë tu ngec problemet. Që sa ka fitu Albin Kurti, e ka qeverinë, një shkollë për 1 vjet duhet me u ndreq. Ka pengesa që krejt janë përgjegjës. Përgjegjësit domethënë janë në nivel qendror. Nuk është tu më interesu Qeveria e Kosovës, se Qeveria është e Kosovës, nuk është qeveri e PDK-së e e LDK-së, nxanësi është nxanës, nxanësi nuk është i PDK-së, as i LDK-së, as i VV-së, jeni bë më të përgjegjshëm. Drejtoria e ka përgjegjësinë me gjetë zgjidhje, s'mujna ne me gjet zgjidhje ku me qu nxënësin. Na mledhemi përdit, folmi na mujm me dhanë propozim, është mirë që ja dhe ti një propozim, nja ja jap unë, nja Iliri. Këta e kanë për detyrë, se kanë marr vendimin, vendimin s'e merr kuvendi. Çka me ba, këta kanë me marr vendimin edhe me marr ma të mirë për ata nxansa qe janë problem i përgjithshëm qe jem tu marr çdo ditë. Nëse nuk kryhet shkolla deri me 1 Shtator, Drejtoria e Arsimit, s'bashku me kryetarin e komunës kanë me marr një vendim këta e jo fshati. Fshati munet me dhanë sugjerime, munet me bashkëpunu fshati, shumë muni me nimu, po do me thanë, vendimi ka mu kanë i drejtorisë, sepse janë përgjegjës me marr vendime. Ne mundemi me dhanë propozime. Këta krejt kanë mi shkru propozimet, mirëpo mos ta bajmë shumë se na jena tu myt tu fol për qet shkollë, nuk po zgjedhet një vendim, po domethënë po domi me mbyll qet problem sa ma shpejt, sa ma mirë. Problemet te krejt qeveritë janë përcjell, ajo është ba bajat, ata e kanë për detyrë, deputet, me shty problemin. Qeverisja e ka për detyrë me shty problemin, drejtoresha e ka për detyrë çdo muaj me i ba kërkesa ministrive, po na nuk e kena për detyrë me fol veç për qeta, se na si zyre s'jem tu e ba, po veç jena tu ba fjalë sinqerisht ne duhet me kërku informata, cila është informata, çka ka ndodh, qekjo është mundësia, tjetër mundësi nuk kam, s'ka me pas as ju, as këta, as na, se është gjynah, veç jena tu ba një temë pa nevojë. Qekjo është gjendja.

z.Musli Neziri: Unë përgjigjen e parë do ta falënderoj për këtë pjesën e ndriçimit, që do t'i thërras për me funksionalizu ndriçimin në rrugën "Kemajl Azizi". Tek pjesa e njoftimit që thojë për "Ekohigjienën", por edhe njoftimin që ju kanë dërgu komuna. Askund nuk përmendet ligji, se në bazë cilit ligj ju kemi shti me pagu, prandaj edhe unë pajtoj që të respektohet ligji. Kompania në fjalë kërkun s'ka përmend ligj, atëherë ai shpresoj që të respektohet ligji atëherë është kryer në veti, ndërsa të pjesa e përgjigjes nga drejtoresha e arsimit, për lidhjen e transferove, drejtoreshë ndëgjo, asnjëherë nuk kam dëshirë dhe është e pamundur njëherë, se s'jam politikan, du me fol realitet, nuk di me bë kritikë, di realitet, Ligji për Transfere ti the se nuk lejon. Në rregull. The se e ke formu një komision. Unë e kam një letër ku është ba një verdikt qysh nga kryesori, absolut nuk ka anëtarë këtu, se kush janë ata anëtar të komisionit që bënë vetëm një kërkesë. Nuk du me mbrojt askënd, por iu është leju këtyre transferi prej shkollës "Safet Rexhepi" në shkollën "Skender Emërllahu". Nxënësit janë të klasës së 3-të dhe çka është ma e keqja, aty mësimdhënësi i cili ka ardh në gjysmëvjetorin e dytë do të thotë në periudhën e dytë të mësimt, mësimdhënësi del në pension, prapë do me thënë për një vit shkollor deri në shtator ju ndërrohen 3 mësimdhënë, prandaj është e dhimbshme, sepse ata janë klasë e 3-të. Dëgjo, unë e di prej nga vinë lokalitetin, kom pas kërkesë direkte. Bëj thirrje në mendje kështu, beso që i kam ndal, s'mu ka dokë në rregull transferi aty ku i kanë ma afër e ta binë një mësimdhënë që prapë del në pension domethënë në shtator fillon një mësues tjetër, sepse ai del në pension, klasa e 3-të është në pyetje, prandaj nëse ju ka refuzu dikujt tjetër drejtoreshë, andaj duhet të jemi me të sinqertë, t'i japim atyre një përgjigje në ankesë ose kërkesë, që e kanë ba. Ky vendim i juaji që është i qum prej qati komisioni, nuk e di kush është, sepse s'ka emër. Është mirë kur thuhet arsyeshmëria, prandaj unë jam për mu respektu konkursi. Në të respektohet konkursi, tek e fundit ligjërisht, absolut nuk jam për me shkel ligjin kurrë në jetën tem, por trajtimi të bëhet i barabartë. Unë nuk po përzina, se nuk i dijë ato punë absolut, as s'du me hi anena, por thjeshtë nëse një mësimdhënë me 20 vjet provojë pune të refuzohet me një komision, që realisht është, nuk ka adresë, vetëm komisioni është, ndërsa ajo që është ba transfer është ba, është e vërtet.

znj.Liridona Bislimi: Po e filloj diskutimin me nënkryetarin. Pjesa e pikës parë, çështjen e parë që e ngrita është shqetësuese, po e përsëris prapë, shqetësuese, edhe është e rrezikshme që çdo herë kur opozita tenton ta ngris një kërkesë konstruktive në raport që ka të bëjë me pjesën e dëshmorëve, pa marr parasysh se çka është ajo kërkesë, nga pozita kthehet përgjigja. Që po mundohet me kriju lidhje tjera, etiketime tjera, nuk është hera e parë që u morr një përgjigje e tillë. E mbaj mend edhe mandatin e kalum kur kanë ngrit çështje që ka të bëjë për dëshmorët, është kthyer një përgjigje e tillë nga ana e juaj. Unë këtë çështje që e ngrita nuk e kam ngrit fikall krye në veti prej Liridonës i nderum, unë këtë çështje e kam ngrit nga përfaqësuesit e familjeve të dëshmorëve, jo vetëm ditëve të zakonshme, po të gjithë që jemi prezent, kur kemi shku për homazhe të varrezat e dëshmorëve, ka pasur raste ku gjendja ka qenë e tmerrshme. Kërkesë e mirëfilltë ka qenë me u caktu punëtori e veçantë e pastrimit për këto pjesë që unë i përmenda. Edhe është një kërkesë që nuk ka ardh prej meje personalisht, kështu që unë kam drejt ta ngris, edhe është e padrejtë prej anës juve me marr një përgjigje të tillë, kinse unë po mundona me anu këtë shqetësim, me ngrit për çështje tjera tek tjetra per web faqen komunale që e pata një sugjerim. Veç dashta ta dijë, a keni ndegju dhe a keni me marr parasysh për shkak se thash, kjo ndihmon shumë në transparencën komunale të pastrimi të varrezave. Siç e përmendi edhe kolegu Nexhat, ju keni fillu në disa lokalitete, është e vërtet, mirëpo sa ka qenë efektive puna e juaj, po flasin qytetarët në disa vende, disa lokalitete ku ka pas nevojë ma shumë, po flas për vendet ma rurale që ka qenë rreziku më i madh për shkak të kanosjes së varrojave nuk keni fillu fare. Kjo është çështja që kam dashur ta ngris dhe drejtoresh un e di që nuk është hera e pare kjo çështje

ndodhe për shkollat që mbyllen. E kam pasur rastin në fshatin tim Drobesh, nuk është leju objekti i shkollës të shfrytëzohet mirëpo ajo ka qenë çështje tjetër. Kjo është një çështje pak më e ndjeshme. Te pjesa akademike nënkryetar, nuk kam vërejtje, e kam përcjellë, çdo gjë ka qenë në rregull, mirëpo tek kjo pjesa para fillimit të akademisë, me të vërtetë është, nuk di si ta cilësoj që mos të ju hapet dera e shkollës familjarëve të dëshmorit edhe këshillit të fshatit për organizimin e këtij manifestimi. Nuk ka pasur diçka tjetër, prandaj unë nuk kam asgjë personale me persona të caktuar, thjeshtë unë po flas për ngjarjen që ka ndodhur. Mendoj që ndonjëherë do të duhet të bëhet ndonjë analizë, se si duhet të këto shkolla bashkë me drejtorët e tyre.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë e di që këshillat e fshatit do të koordinohet për aktivitetet në shkolla, sepse zakonisht në qat formë koordinohemi përherë për aktivitetet që bëhen në fshat, se fshati nuk kanë objekt tjetër, e kanë shkollën dhe e shfrytëzojnë jo për përfitime, po për çdo aktivitet edhe aktivitete politike që janë të ndalume. Ne, domethënë të gjitha partitë edhe në fushat ligjërojmë në shkollë për shkak që nuk ka objekte tjera. E vetmja shkolla është një objekt që na e mundëson me shfrytëzimin, mirëpo kur ka kanjeher telashe, ka mos koordinime mes veti se nuk ka vend.

Drejtoresha, znj.Fatbardha Emini: Personalisht nuk kam qenë e informuar nëse ka pas një çështje të tillë. Unë i shkrova drejtorit, absolut kërkuj na nuk ju ka mbyll shkolla, pra gabimi koordinues i këshillit të fshatit. Do ta pyes pse ka ardhur kjo informatë kështu apo dezinformtë lidhur që s'ju ka leju shkolla. Domethënë unë për herë të parë e dëgjova, nuk është mirë me institucion nëpër kafe të flitet gjithçka. Nuk po të drejtohem Liridona vetëm ty, po të gjithëve juve këtu. Është mirë pak a shumë me i sit informatat, me ardhur personalisht me diskutu njëherë në institucion, sepse për atë jemi këtu, pastaj me ardhur me fol para mediave, para qytetarëve, sepse jemi 24 orë në shërbim si drejtorja. Në çoftese ndonjë institucion bënë ndonjë gabim eventual, ndonjë shkelje ligji, në jemi për me zgjedh, por nuk jena në këtë mënyrë një informatë të pakonfirmime me plasur në mediave dhe para qytetarëve, sepse kjo na ka ndodhur që qytetarët shumë herë i kanë ushqyer me informata të pavërteta dhe të painformuar. Më vjen keq, sepse drejtori i shkollës është njeri prej drejtorëve të shkollave me numrin e madh, që jashtëzakonisht jam e kënaqur me përkushtimin institucional që e kanë.

znj.Liridona Bislimi: Informacioni që kam marr, nuk është aspak prej kafeneve ose prej vendeve që i quajti ti. Informacioni është marr nga kryetari i këshillit të fshatit si dhe familjaret e afërt të kolonelit. Unë nuk di se nga kush tjetër duhet me zyrtarizuar që ka ndodhur rasti sipas jush. Unë po flas konkretisht, takime kam mbajtur personalisht, kështu që nëse ju e cilësoni që nuk është e vërtetë, atëherë mbetet në ndërgjegjen tuaj. Shumë mirë e the, unë vetëm kërkoj që rasti të mos përsëritet, për shkak se nuk është e drejtë si institucion të kemi kesi raste të tilla, të paraqitemi me kesi raste të tilla.

znj.Majlinda Shabani: Unë kam qenë kryetare e Këshillit Organizativ të Fshatit Lubishtë. Po du me e njoftu opinionin se, është një keqkuptim përkundrazi drejtori i shkollës së fshatit Lubishtë ka ofru bashkëpunim të vazhdueshëm. Prej anës se këshillit organizativ nuk është kerku leje me u mbajtur akademia në shkollë, po është kerku leja me u mbajtur në shtëpinë e kulturës, d.m.th është një lloj keqkuptimi. Po ndihem shumë keq, po me qenë që unë e kam udhëhequr akademinë, e di bashkëpunimin që e ka pas drejtori i shkollës në Lubishtë, e po du me i kerku falje në emrin personal, ndoshta edhe në emër të koleges.

z.Basri Sylejmani: Zotri kryesues, unë si familje e dëshmorëve Gursel e Bajram Sylejmanit, unë plotësisht reagoj ndaj këshilltares, e cila thotë se, nuk ka pastërti. Ne e dimë shumë mirë se, në fshatin Sodovinë ka pastërti. Një nder lapidaret më të mëdhej në Kosovë, e cila ka pastërti që edhe kryp me ngjy në ta, edhe tek përmendoret tjera ka pastërti. Mu me vjen turp me thënë ajo se çka është tu ba, kurse çdo kund në Viti lapidaret mbahen si

është me se miri. Unë çdo ditë i shof punëtorët në qendër, e mu me vjen turp me thanë atë fjalë, se te familja jonë Sylejmani, edhe Komuna në Viti, po edhe është njeri ne Sodovinë qe e mirëmban përmendoren.

z.Illir Zuka: Kryesues, së pari herë po ndihna shumë keq, se përpall mënyrën e dhezjes se mikrofonit dhe marrjen e fjalës, sikur s'është kërkush. Ne po mundohemi me të respektu deri në pikë të fundit, asnjëherë nuk e kam marr fjalën pa ma dhanë ti. Unë po flas në cilësinë e administratorit. Të jesh i bindur që, qytetarët nuk e dinë saktë se ku është problemi për shkollën e Pozharanit.

z.Ramadan Deliu: Unë i kisha kërkua znj.Liridona me dal me kërkua falje, pasi qe ja shkaroj çështjen e duhet me qenë korrekte.

z.Taulant Haxhiu: Unë jam ne mandatin e dytë, po ju jep shumë hapësirë, replika është 1 minut. Shefat e grupeve i kanë 5 minuta. Unë në seancën tjetër në koordinim me partin e koalicionit ka me propozu që, pyetjet dhe përgjigjet me dal në piken e fundit të rendit të ditës.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Njeri këshilltar me thotë, nuk ke fillu me i hek varrojat, tjetri me thotë je tu i hek keq. Unë u përgjigja, që kam fillu me i hek. Liridona tha s'keni fillu, thash kemi fillu. Nexhati tha keni fillu po keq, ama mujnë mu përmirësu masi është keq. Domethënë mujm, veç me rëndësi është e vërtet qe puna është fillu. Tjetra që është shumë me rëndësi, jo një, unë nuk kam qysh e quj tjetër përveç folklorizmit. E dini qe mirëmbahen varrezat e dëshmorëve. Unë nuk jam idhtar me i përmend emrat. I respektoj shumë, mu thirr ne emër te tyre, kam qef me i respektu edhe kam qef me i mirëmbajta ato ne mesin e atyre planeve për mirëmbajtjen e hapësirave. Koordinator kam qenë edhe unë, dhe me lujtë me atë me sill, unë nuk kam qysh thamë tjetër përveç folklorizëm. Krejt ta dëshmojnë se, varrezat e dëshmorëve janë tu u mirëmbajta, në të qohet dikush në të thotë se kemi shku me bë homazhe, qetu nuk ka qenë mirëmbajtja, jo vetëm sivjet edhe sheshi qe e përmendi ndikimi politik po ndikon. E ke lyp regjistrin, kemi me ta pru kur te mbahet seanca. A jeni tu e shfrytëzu ndikimin në aspekt përfundimin e tyre. Po ti dje e ke pas përmes mjeteve te informimit kryetarin, i cili e ripërtërinë memorandumit, ka qenë memorandumit, naj kanë ndalu dje, e ke pas te Mjakit dhe Stublles dhe je tu ba përpjekje te vazhdueshme edhe për këto projekte dyvjeçare dhe tri. Sa do te jet zgjedhje e arsyeshme, ata e dinë më mirë. Ku me ditë sa letra i kem te qume për palestrën e sportit, sa letra i kem të qume për shkollën e Pozharanit. Gjitha projektet te cilat i kam potencu ne një takim te cilët nuk i ka udhëheq komuna, na u kan zhagit me vite. Ata te cilët i ka udhëheq komuna i kemi perfundu me afatin e vet, kjo është një realitet as pa dashtë me akuzu Albinin as Hotin, as Thaçin, kjo formulë qe e tha kryesuesi me herët, duhet te zgjidhet nga ana e tyre. Ne disa kërkesa i kemi bë në cilësinë e kryetarit dhe me nënkryetar. Nëse keni vendos me na nda buxhetin, qitni paret në komunë, unë po i udhëheqi procedurat, unë e përfundoj projektin, ama në qet forme nuk po përfundohet. Dhe në fund duhet me pranë që, edhe unë jam Kosovë, po e përsëris edhe njëherë, më ka pas pyet Remziu, por me sinqeritet kur do dilni në komunë të re. Kurr se harroj dhe s'kisha çka me i thanë, i thash me u kanë paret e komunës mrena mujit ka me dal edhe te qeverisë muj me ta thanë. Po te Bashkimit Evropian s'po guxoj me të thanë hiq, se s'ta përfundon sikur te ujësjellësi. Po unë s'muj me prish marrëveshjen e Ministrisë për Zhvillim Ekonomik. S'muj, është nivel Kosove ajo.

z.Ali Bajrami: Fyerja qe u ba ndaj drejtoreshës se arsimit, ne të mbetet ne ndërgjegjen e saj që tha, pas shpjegimit që tha kjo në të mbetet në ndërgjegjen e Liridonës qe po më vjen keq qe nuk është këtu, po kur të akuzon, është mirë me nejt deri ne fund që me i dëgju.

z.Nexhat Halili: Përsëritje nënkryetar! Unë fola nëse ka kontratë dyvjeçare edhe vitin e kalum ka afat. Nënkryetar, buxheti planifikohet për këtë vit. Zotëri kryetar, u kanë dashtë të analizohet këtë vit, të ndahen mjetet

për qat kontratë që ekziston, jo të lidhet kontratë tjetër. Zotëri kryetar, merrne analizione kontratën, merrne analizione vlerën e kontratës, merrne analizione afatin financiar të asaj kontrate. Mu po me vjen keq sado kudo nëse nuk i kuptoj këto, mund të jenë. Sa i përket lidhjes se punimit, i kuptoj pak. Edhe një tjetër që kesh tu u lidh. Tek ankesat, tek bordi i OSHP-së, zotëri kryetar, është e vërtet që nuk ka ekzistuar bordi i OSHP-së, po mungesa e bordit të OSHP-së nuk ju ka ndal juve me e bë raportin. E keni rastin e rrugës Viti – Kerbliq, e keni nënshkru pa vendim të organi të OSHP-së. Te pastrimi i rrugëve nënkryetarë, është e vërtet që kanë fillu, po edhe njëherë po thamë katastrofë, duhet edhe njëherë me ardh me i pastru, nuk jam pastru qysh duhet, qysh lejohet me standarde, eja kqyre rrugën.

z.Basri Sylejmani: Nëse është ashtu, ne si komision kem të drejtë me shku me verifiku, edhe mi pru të dhënat taman të sakta, edhe mandatin e kalum. Qashtu për shkollën e Pozheranit, s'ka nxemje, s'ka aty kur shku aty, krejt në rregull edhe këtu nëse është në rregull ne e shohim, nëse s'është ne e shohim.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Pasi përfundimit jashtë rendit të ditës, për këtë seancë kemi parapa këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja a pestë e rregullt e KK-së.
 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2023-2025.
 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetori të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023.
 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2022.
 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022.
 6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore për vitin 2022.
 7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin për shqyrtimin dhe aprovimin e kodit të etikës për zyrtaret e Komunës së Vitisë.
 8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit.
 9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit.
 10. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin për formimin e komisioni vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës paluajtshme te komunës ne shfrytëzim. (pa shqyrtim në KPF).
 11. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin për formimin e komisioni vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës paluajtshme te komunës ne shfrytëzim. (pa shqyrtim në KPF).
- Dhe për këtë seancë, në konsultim edhe me Drejtorin për Financa edhe në bazë të nevojës që kemi për kuvendit komunal, në bazë të buxhetit që kemi, ne kuvendi komunal kemi mëndu që të pajisemi me lloptopa, të marrim një vendim sot që te furnizohem me pajisje-llop top për këshilltarët komunal dhe sekretarinë e kuvendit.

A jeni për miratimin e rendit të ditës me këtë pikën shtesë? Me ngritje dore! Nga të gjithë prezent u miratu rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja a peste e rregullt e KK-së

z.Bekim Azizi, Kryesues i kuvendit: Hapi debat për diskutim për pikën e parë të rendit të ditës.

z.Musli Neziri: Te fjalimi i parë është emri im, kështu që ky nuk është fjalimi im.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, qes në votim për miratim pikën e parë të rendit të ditës. Me 19 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim, miratohet pika e parë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2023-2025

z.Besnik Imeri, drejtor i financave: Përshëndetje te gjithë! Para jush me lejoni te prezantoj kornizën afatmesme buxhetore te Komunës se Vitisë te vitit 2023/2025 në pranimin e qarkores se parë buxhetore 2023/01 nga Ministria për Financa dhe Transfere te komunës, jemi njoftuar me qarkoren po ashtu edhe komuna jon është e obliguar qe te përgatis kornizën e ardhshme buxhetore komunale për vitin 2023/2025 kemi analizuar qarkoren e Ministrisë se Financave dhe kemi përgatitur qarkoren buxhetore komunale se bashku me qarkoren e Ministrisë se Financave, në baze te kërkesave te arsyeshme udhëheqësve kemi përgatitur edhe planin e buxhetit te vitit 2023 si dhe vlerësimin buxhetor për vitin 2024 dhe 2025, pas aprovimit qe do t'ju bëhet ne kuvendin komunal, do t'i përcjellim të departamenti i buxhetit te Ministrisë së Financave. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetjet shtesë jam ne dispozicionin e juaj.

z.Bekim Azizi, Kryesues i kuvendit: Faleminderit drejtor! Meqenëse është propozimi i parë kemi pas edhe një debat te organizuar nga KPF, kemi organizu me drejtorin dhe qytetarët kemi dhanë shumë mendime se si duhet bërë një plan i mirë. Besoj se në shtator do të kyqemi edhe ne si kuvend, si këshilltar komunal, ma shumë dhe sa më mirë qe e bëjmë një buxhet do te jet me i zbatueshëm për vitin ne vijim. Unë para se me hap debatin, sot ka mungesa më shumë, për shkak se koha e pushimeve, dhe e kisha lidh një çështje te seancës solemne, gjysma e këshilltarëve me mungu ne seancë solemne, ju kisha kërku sepse seancat solemne për ditë te çlirimit janë ditët shumë te veçanta te këtij vendi, janë kur njerëzit kanë dhënë me se shumti për këtë vend. Ju kisha kerku, që së paku ne seancën solemne duhet te jen këtu. Hapim debat për këtë pike të rendit të ditës.

z.Taulant Haxhiu: Një vërejtje drejtor. Është mirë kur të sqarosh çdo sen, beje me shifra e kemi mbështet këta, e kemi mbështet sportin. Unë i shikova shpenzimet të planifikuara për vitin 2023/2025, kërkesa ime është te investohet, te ndahen mjete financiare me shumë ne ambiente, ujësjellës, duke e ditur se nuk ka ujë te mjaftueshëm. Po ashtu ne rrjet te kanalizimit kërkohet me tepër, qe ne fund çështjen e rrjeteve e kanalizimit ta përfundojmë ne Viti dhe lokalitetet tjera te Vitisë. Planifikimet e sektorëve veç e veç te jenë, pasi ne fund ato qe kemi planifiku te jenë te sakta.

z.Ali Bajrami: Faleminderit kryesues! Një përshëndetje shkon edhe për kryetarin, pasi na u bashkëngjiti ne kuvend. Sa i përket kornizës afat mesme buxhetore, nëse hymë me shifra dhe e bëjmë analize të hyrat komunale janë vetanake. Ajo qe është e mire ne këtë kornizë afatmesme buxhetore, qe kemi rritje edhe nga grandit qeveritar edhe nga të hyrat vetanake, kur e bëjmë një aludim të kësaj, kemi rritje edhe te buxheti ne vlerë prej 1 milion e 778515 euro. D.m.th krejt kjo te grandit i përgjithshëm, vlera është 1 milion e 500 mijë euro. Ajo qe është pak shqetësuese, qe kemi një ramje, ku ne përqindje kemi, po për te përgëzuar është se kemi një rritje për 233 mije

euro ne shëndetësi. Ajo qe me ra ne sy kemi rritje te te subvencioneve edhe sa i përket subvencionimit te OJQ-ve ndryshme qe funksionojnë ne Komunën e Vitisë qe vlera ka qenë 50 mijë tash e kemi 100 mijë, ndërsa te bursa ka qenë 50 mijë u be 60 mijë. Ajo që është për tu përgëzua kemi investime te projektit kapitale, e kemi një rritje prej 3 milion e 680 mijë e 755 euro ose ne përqindje 24.18%. Qekjo na bënë qe te kem projekte dhe investime edhe prekim çdo lokalitet dhe krejt këtë ne shërbim për te mirën e qytetareve te Komunës se Vitisë. Ajo çka pash qe nuk ish e paraqitne, ishin projektet për investime kapitale. Nga praktikat e kalume qe i kemi pas gjithherë, muaji Korrik ka qenë debat me qytetar. Janë marr projektet, janë analizu, kanë ardh në ekzekutiv, ne bashkëpunim me kryetarin janë nxjerr prioritetet dhe janë ba investimet ne ato lokalitete dhe ne atë infrastrukturë qe ka qenë jo e kompletume dhe që kanë pas nevojë qytetarët, prandaj për krejt këtë pasqyrë është e miëe qe rritja e buxhetit për komunën për vitin 2023 është e konsolidushme dhe besoj qe do ta analizojmë, do ta inkorporojmë aty ku ka nevojë dhe do ta shpenzojmë ashtu siç i kemi shfrytëzuar edhe buxhetet e viteve e kalume.

z.Nexhat Halili: Përshëndetje nënkryetar! Unë drejtorin e financave e përgëzoj për këtë punë qe ka bërë për atë kornizën afatmesme buxhetore, po unë tash pak po ndërlidhja rreth kësaj kornize. Tek pikat e zhvillimit ekonomik, ne kërkojmë qe ne komunë nuk ka kompetenca te krijohen vende te punës ose te merren me gjana qe janë te nivelit qendror ose ne çështje te biznesit, mirëpo komuna ne baza te pikës te zhvillimit ekonomik, unë shoh qe orientimin me te madh tek çështja e bujqësisë, po unë e kam një propozim këtu, qe te paktën komuna për zhvillimin e bizneseve si nga investitorë te jashtë edhe për investitorët e brendshëm t'i jepet mundësia si vend për zhvillim te biznesit te paktën se bashku me institucionet qendrore t'i koordinoj politikat fiskale favorizuese për këto biznese. Komuna ka ne skenë t'ju krijoj edhe çështjen e kanalizimit dhe ujësjellësit në gjitha pikat tjera Komuna e Vitisë ka mundësi ne këtë kornizë me potencu se Komuna e Vitisë është bujqësore, duke shfrytëzua lumin “Morava e Binçes”, shumë fshatra mund t'ju mundësohet rregullimi i ujësjellësit dhe ta shfrytëzojnë për toka bujqësore. Tek shëndetësia dhe mirëqenia sociale, në këtë dokument po shoh se janë diku 6 punkte të mjekësisë familjare dhe nga Qendra e Mjekësisë Familjare “Nëna Terezë” ne Viti dhe ambullanta ne Pozheran, mirëpo mu me brengos se ne shumicën punkteve nuk ka mjek. Në te ardhmen propozoj qe ne bazë te kësaj kornize, për shkak se dikun është e parapame edhe punësimi i 6 mjekeve, qe te orientohen neper këto punkte dhe ne te ardhmen te hapen edhe punkte tjera ne Komunën e Vitisë, aty ku është e nevojshme dhe aty ku parashihen. Unë po i shohë këto shërbime te cilat kryhen ne Qendrën e Mjekësisë Familjare ne Viti, po unë propozoj qe te përfshihet mamogrami, papatesti dhe tjerat te cilat janë te nevojshme për qytetarët. Kam një propozim tjetër. Në te ardhmen duhet te bëjmë përpjekje maksimale përmes qeverisë dhe institucionet te ju mundësohet ndërtimi i një shtëpie të pleqve. Te arsimit, në baze kësaj qarkore shihet se ka zvogëlim te numrit te nxënësve. Na vjen keq pse po ndodh kjo, po kjo nuk është kompetenca e komunës, se kjo po ndodh ne te gjitha komunat e Kosovës. Unë propozoj që, ne te ardhmen me këtë kornizë buxhetore, vitet e ardhshme, ne secilat shkolla te paktën te ketë nga një klasë te cilat i shfrytëzojmë si çerdhe për parashkollor. Dhe ne fund, ne komunën tonë ekzistojnë dy çerdhe, çerdhja ne Qifllak, ne vitet e ardhshme do te ketë edhe çerdhe tjera. Unë ju përgëzoj, kam dëshirë qe te punohet ne këtë drejtim, bile të paktën vitin e parë te ketë një çerdhe, në të ardhmen të ketë edhe tjera. Sa i përket te hyrave komunale, gjatë analizës shihet se është ba përkushtim i madh dhe ka rritje te grandit qeveritar edhe te hyrat vetanake, mirëpo mu me shqetëson tjetra çështja. Në drejtori ka edhe zvogëlim te te hyrave, sidomos tek Drejtoria e Administratës, Urbanizmit, e Shëndetësisë dhe Inspektoratit. Nuk po mund ta di pse kjo gjendje. E dimë se te hyrat te planifikuara për 2023

ne vend se te rritet angazhimi, te rrisim performancen e drejtoresve, ne po shkojme te kunderten, po shkojme ne zvogelimin e te hyrave. Te hyrat komunale qe prej vitit 2022 -2023 kemi rënie, sidomos ne leje te ndertimit, certifikatat e lindjes, te hyrat nga qiraja, per objektet shendetesore kemi 8640 euro. Sa kanë qen ne vitin 2022 e ne vitin 2023 janë zero, pse mu ndërpre kontrata. Tatimi në pronë ka ramje. Tek politikat e reja, nga politikat e reja shihet si nje burim i ri per vitin 2023, pra te hyrat komunale, tatimi ne tokë, ku beje pyetje. Tatimi ne toke per 2023 a parashihet, a është aprovu ligji apo si parashihet ky inkasim i këtyre te hyrave? Se nëse nuk realizohet dhe nëse behet Ligji për 2023, atëherë nuk o kjo vlerë prej 200 e diçka milion euro. Sa ke kjo vlerë, do te zbritet prej tatimit ne te hyrat e 2023, kur t'i zbresim tatimin në tokë, na dalin se te hyrat e 2023 janë me te vogla se 2022. Nëse nuk realizohet kjo nga mbulohen këto te hyra për 2023, qe deri te paktën te dihet niveli i 2022 te shpenzimet paga dhe shtesa paga, dihet se këto e marrin shumen ma te madhe qe ekziston në kuadër te shërbimit ka një rritje, d.m.th rritja e çmimeve e ka ba te veten dhe ka gjithçka rritje subvencionet dhe transferet. Kryetari pranoj se është be një shlim. Ok gjithçka ne rregull pra shuma me e vogël e transferev është te Zyra e Kryearit i ka 120 mijë euro Drejtoria e Bujqësisë i pat 300 mijë euro dhe vinë tash kultura dhe shërbimet sociale. Unë ju kisha propozu, tash propozimi jem qe bile te paktën një pjesë te subvencioneve te kryetarit te orientohen te shërbimet sociale, 120 mijë un propozoj. Tash kemi rastin te investimet kapitale, unë nuk po muj me ba analizë po për shkak se nuk kemi një tabelë për orientim, cilat projekte parashihen për vitin 2023? Unë dashta me kornizën afatmesme përfundimtare, mirëpo thash nëse unë kërkuj një projekt, ku do te ketë kornizë, unë nuk po muj me ditë qaj projekt a ekziston në këtë kornizë qe me ba kërkesën. Tek investimet kapitale shohë se, shumica e buxhetit është i orientum te Drejtoria e Financave. Drejtoria e Financave menaxhon te paken edhe për investimet kapitale te orientohet ne drejtoritë përkatëse. Secila drejtori t'i ketë investimet e veta dhe t'i menaxhoj këto investime.

znj.Majlinda Shabani: Po du me u ndërlidh te puna e KAB-it, meqenëse morëm diskutime, po besoj qe prej anës komunës prioritet. Duhet me pas ujin, meqenëse është viti i nëntë i qeverisjes edhe e kem pikërisht këtë problem. E permeni edhe një asamblist, qe ne KAB, ne pasqyrë, po nuk po na figurojnë konkretisht orientimin se ka ka me shku qeky bugjet domethan per 3 vitet e ardhshme mënoj qe është mirë me ba një vlerësim te gjendjes aktuale se ku jemi paraprakisht edhe me pa ma te saktë se ku ka me u orientu qeky buxhet edhe ne dëgjimin publik qe e kemi pas me drejtorin e financave kom propozu qe eshte mir me pas edhe nje pasqyr te projekteve te cilat kanë mbet pa u mbaru, domethënë prej viteve paraprake. Po besoj qe viti 2022/2023 duhet me shku tu i perfundu projektet të cilat kanë mbet pa u përfundu ose te paktën me na tregu se, çka ka me ndodh me ato projekte. Te pika e dytë e kemi strategjinë e cila ka kalu ne kuvend për dhunën ne familje, domethënë e dimë qe edhe kjo ka një kosto financiare. Mënoj qe është mirë mu pa edhe kjo ne kornizë. Te e treta, e dimë qe komuna vit pas viti është duke pagu eventualisht 180 mi deri ne 200 mi vendime gjyqësore. Shtroj pyetjen këtu përsëri, pse nuk janë parapa ne kornizë, edhe mënoj qe edhe këto janë te nevojshme mu pa, gjithashtu edhe pagat jubilarë, mendoj qe edhe kjo është një çështje e rëndësishme, e cila duhet me u parapa në kornizë. E kemi edhe rivlerësimin e pronave. Është e gjetur e auditorit, nuk jan rivlersu se çka ju takon me ligj. E dimë qe duhet me u formu një komision, se llogariten te hyrat edhe shpenzimet për 3 vitet e ardhshme. Gjithashtu edhe ne aspektin e barazisë gjinore e dimë se sa është me rëndësi me pas ndarje te barabartë te buxhetit. E dimë qe me rregullore nuk na takon me pas një mamogram, për shkak se kjo shkon me kok banori, mirëpo si komunë te paktën të kishim mujtë me ba subvencionim e papatestit, edhe qe i kishim mundësu grave me pas mundësi me ba papatestin.

z.Illir Zuka: Unë edhe dëgjimin publik kur e kemi majt, domethënë i kam ngrit nja 3 çështje te subvencionet. E përgëzoj egzekutivin edhe drejtorin e financave që ka bërë rritje 100% subvencionet në kulturë, gjithashtu edhe tek subvencionet në bujqësi që janë shumë të nevojshme për qytetarët e Komunës së Vitisë, gjithashtu edhe tek shëndetësia u kanë shumë punë e mirë që kemi rritje të buxheti, diçka që më ka ra në sy, domethënë të rritja e mjeteve, të hyrjeve, grumbullimi nga qytetarët është 64 mijë e 951 euro. Na e dina që pasqyrat financiare në 3-mujorin e parë domethënë kemi pas ma pak mjete të grumbulluara se vitin e kaluar, për arsye se një vendim i qeveris, domethënë që është heqja e vërtetimi obligativ, me qenë prej Drejtorisë së Financave që është për tatimin në pagesë. Edhe a kemi bërë një plan tjetër për grumbullim të këtyre mjeteve? Për shkak na mungon me rrit, po mungon me dal keq në grumbullim. Edhe një diçka tjetër, e kam propozuar edhe në seancën e parë, e kemi diskutuar edhe me kryesuesin. Na e kemi rregulloren për mirëmbajtjen e varrezave. Është mirë me parapa në buxhet, që prej vitit të ardhshëm është rregullorja për mirëmbajtjen e varrezave të Komunës së Vitisë, veç ta planifikojmë me buxhet.

znj.Liridona Bislimi: Ashtu siç e kam potencuar edhe në mbledhjen e fundit të Komunitetit për Politikë dhe Financa, si dhe korniza afatmesme buxhetore është një dokument mjaft me rëndësi që paraqet mjetet e buxhetit në dispozicion, e që lidhen me prioritetet e komunës për periudhën 3 vjeçare. Njësoj sikur edhe vitet paraprake, nga analizat dhe krahasimet që i kemi bërë me vitet e kaluara, kemi ardhur në përfundim që nuk ka diçka të re kreative dhe të përcaktuara në objektivat të kësaj dokumenti pa dashur të hi në përsëritje të diskutimit, duke pasur parasysh faktin që përgjigja që me është ofruar gjatë mbledhjes së Komunitetit për Politikë dhe Financa, që ky është një draft dokument që ende është në përpunim e sipër, megjithatë disa tema do duhet t'i kemi parasysh në si për banorët vitias, duhet të theksojmë se ende pas 9 vitesh qeverisje kemi mungesë të mamografisë të Komunës së Vitisë si dhe papatesti ende nuk subvencionohet. Kjo ka qenë kërkesë edhe nga lobi për barazi gjinore, diku para 5 vitesh dhe ka qenë një premtim komunal që do të realizohet, por siç duket ende nuk është në implementim. Kemi komunitet tjerë me buxhet sa po i yni dhe këto shërbime jetive ju ofrojnë qytetarëve tanë, pse po ndodh kështu kryetar? Komuna e Shtimes, gjatë seancës së fundit të saj përmes kuvendit komunal ka marrë vendim për të gjitha nënat lehonat të Shtimes të jenë përfutuese të shumës prej 100 euro për çdo fëmijë të lindur gjatë vitit 2022 pse nuk është menduar një politikë e tillë të implementohet edhe për gratë nga Komuna e Vitisë që nga viti 2015. Një çështje e tillë është duke u përmendur në kuvendet komunale, por asnjëherë nuk është marrë parasysh si dhe çështje apo shqetësimi kryesor i qytetarëve vitias, i cili i ka përcjellë tash e 9 vite me juve në qeverisje është mungesa e ujit të pijshëm ashtu siç edhe kemi diskutuar edhe në komunitetin e fundit. Po shpresojmë që ky buxhet do të jetë ai i cili me në fund do ta bëjë zgjidhjen e këtij problemi që po shqetëson qytetarët tonë për një afat mjaft të gjatë.

z.Basri Sylejmani: Edhe unë do të foli pak, se foli edhe shefi i grupit parlamentar mas shumti unë do ta cekim po më vjen mirë që kemi pas 3 mbledhjeve që kësaj është e 3 me Demosin kemi pas për çështje të buxhetit të shfrytëzimit, çështjes së buxhetit kemi pas edhe që kemi pas të fundit jepet në kuvend. Këtu tash po më vjen mirë që në shëndetësi ka rritje, në bujqësi edhe aty ka rritje në sport po në arsim deri dikur po mase ka nda edhe për studenta me javë rrit pak për studenta bursën. Unë kaq kisha me thanë, mu më vjen mirë se ka rritje edhe kaq.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Se na e dimë që qarkorja buxhetore shkon në ministri, ministria nuk do të thotë që ka me i pranuar propozimet tona komplet 100%, mun me naj jek naj kod me naj shtu naj kod me naj zvoglu domethënë dikur, mirëpo propozimi i parë që behet që votohet sot shkon në ministri dhe ministrinë e lidhin, i

shqyrtojnë dhe ata naj kthejnë qe vjen ne shqyrtim ne pjesën e dytë ka mundësi, se s'janë subvencionet qe i kemi rrit 100% i kemi propozu na për rritje ka mundësi mos me naj pranu me naj ul ata, mirëpo parimisht na domethënë si kuvend si qeverisje lokale jem te ba orientimin ne këtë formë unë mënoq qe debatet tona gjat këtyre 3 muajve s'bashku duhet t'i orientojmë te investimet kapitale në propozim projekte ne buxhetin qe do te miratohet në shtator, sepse pjesa e investimeve kapitale është ajo qe duhet te diskutohet me shumë, sepse pjesët tjera, shërbime, mallra, pjesa e pagave janë të padiskutueshme, sepse ata janë nevoja te përditshme, mirëpo pjesa e 3.6 milion qe është për vitin 2023, aty domethënë duhet t'i specifikojmë projektet të cilat duhet te kryhen ose realizohen për vitin e ardhshëm.

Drejtor, z.Besnik Imeri: Faleminderit shumë për sugjerimet dhe kritikën qe naj dhatë, gjitha sugjerimet i morra me shkrim, gjithashtu kisha dashtë qe kur te vjen orari i dëgjimeve buxhetore neper lokalitetet ku këna me kanë këshilltarët komunal e luajnë një rol shumë të madh qe vinë prej atij lokaliteti. Influenca e tyre është shumë me rëndësi me marr pjesë edhe mi paraqit kërkesat nevojat e qytetareve ne çdo lokalitet. Faleminderit shumë edhe njëherë.

Kryeatri i komunes, z.Sokol Haliti: Faleminderit kryesues përshëndetje te nderuar këshilltar komunal nen kryetar qeveri komunale OSBE, media te shkrume elektronike , drejtor ndoshta ke e udhës me ju përgjigj nje pjesë te pyjeve ishin konstruktive dhe shumë parimore shumica edhe në vazhden e punës qe duhet me ba kuvendi, faktikisht edhe qeveria komunale bashkë me një debat ne qarkore buxhetore për shkak se nuk kemi përditë mundësi me ba këtë. Mirë qe është majt debati me Demosin, mirë qe eshte zhvillu ne Komunitet për Politikë dhe Financa një debat i tillë, mirë qe edhe bordi e ka debatu qarkoren, po mbi te gjitha është tepër mirë qe kemi rritje enorme, rritje te cilën e kemi kerku krejt pa dallim prej grupeve parlamentare, prej partive politike dhe i kemi premtu te gjithë edhe i kemi kërku rritjen e subvencioneve ne kulturë dhe sport, e kemi kerku rritjen në bujqësi, e kemi kërku rritjen te asistenca sociale, te kategoritë qe vërtet kanë nevojë shumë, e kemi kerku rritjen te studentat, e aty deshta me tu përgjigj Nexhat, këshilltar me respekt po me bashkëbisedu se edhe subvencionet e kryetarit vetëm duhet me ditë ku orientohet. Nëse orientohet nëse orientohen te studentat hargjimet e varrimeve e te tjera domethan jan aspekte qe nuk duhet mi lan anash edhe ato për shkak se edhe ato e kanë një buxhet një kosto qe është e planifikume, domethënë e saktë ose për afërsisht e saktë. Përshembull te harxhimet e varrimeve mun me qenë për afërsisht të sakta për shkak se aty tjetër kush i ka ato vendime supreme, po te studentët përshembull e dina sa kushton, e tjera. Domethënë kjo është tema qe nuk këna dashtë me lan as këtë kategori, as ata pa rritje, rritje kanë te gjitha, mbi te gjitha e rëndësishme është qe rritje kanë investimet kapitale. Po mos harroni se 1 milion e gjysmë kanë qenë. Vetëm shikoni ne vitin 2014, sot domethënë qarkorja e re i parasheh 3 milion e 680 mijë euro, kemi mujt edhe 4 milion po i kishim lan këto kategori te cilat i diskutuam, prandaj kemi dashtë një rritje të përgjithshme me ba, në të gjitha kategoritë. Unë besoj qe kemi me dal mirë. Mirë e tha edhe kryesuesi edhe ju te tjerët këshilltar qe duhet me ba planifikime te mira ne seancën dëgjimore për buxhet, kemi me mbajt edhe sivjet si komunë sikur çdo vit. Aty duhet me marr pjesë aktiv te gjithë me morr edhe me i pa lokalitetet ku i kemi nevojat. U ngritën edhe çështjet tjera qe janë me rënësi edhe e ujit, pse jo sivjet ne e kemi një buxhet të ndarë nga viti i kalum, qe e kemi miratu ne kuvend do të shikojmë si do mujm me implementu suksesshëm. Kemi pas shumë kujdes në mënyrë qe me te vërtet te kemi efektivitet me ato 200 e 22 mijë euro, me ato te cilat i kemi te ndamë janë pak po janë mjaftueshëm sivjet. Vitin e ardhshëm me naj qel rrugën qe vërtet me përmbyll për shkak se, nëse ne e përmbyllmi këtë fazë qe quhet faza 4, faza 5, faza 6, pse po i përmendi te triat, kem ende fazës 4, fazën 5 pa e përfundu. Nëse arrijmë qe ne gusht normalisht

qe me fajin tonë po janë donatorët te Qeveria e Kosovës, është Agjencia Zvicrane Implementuese, është “Hidromorava” aty, komuna i ka kry obligimet e veta suksesshëm, tu përfshi edhe bashkëpariticimin për Stubell, qe ka qenë 125 mijë euro, por megjithatë ne insistojmë, duhet me insistu si institucionet si kuvend qe me shku suksesshëm përfundimi i projekteve, atëherë kemi me pa çka ne mbetet edhe ne fazën e 7, e faza e 7 nënkupton edhe projektin për Ramjan, për Fshat të Ri, projektin për Radivojc, për Devaj, nënkupton projektin për Lubishtë për Buzovik, Shusht dhe nuk e di kush mbetet, por janë këtu edhe fshatrat e tjera rritja e kapaciteteve te ujit qe e kemi për Kabash, për Binq, stabiliteti dhe funksionimi i rrjetit për Skifteraj, gjithashtu rivitalizimi i rrjetit të Begunces, për shkak se ka pas problematike qe duhet me rregullu. Në anën tjetër i Zhitisë qe duhet me u marr nen mbikëqyrje, gjithashtu të triat prej “Hidromoraves” qe ka obligim ligjor sa ma shpejt me drejtorin e ri “hidromoraves” do te kemi kontakt dhe takim për shkak se sa e dijë ka ndërrime, ndërsa ne aspektin tjetër ne duhet me shiku për mbylljen e projektit te ujësjellësit në Smirë edhe në Verban, për shkak se është afër përmbylljes edhe në Goshicë, gjithashtu edhe ne Germovë është kry në Letnicë janë lshu në Podgorc është afër, kemi problem me lokacion, kemi punu në ndërtim të zgjidhjes se pronës atje, për ndërtimin e bazentit te ri dhe gjithashtu 5 fshatrat qe i kemi tash e kemi pas atë problemin ju e dini se është ba natyrisht “Hidromorava” dhe enti i shërbimit antihigjienik e ka për detyrë natyrisht, po mbi te gjitha “Hidromorava” qe ta rregullon këtë aspekt, bashkë me donatorin, ne mënyrë qe ne kemi parametra të saktë kualitativ te këtij uji, ndërsa ujë te bollshëm kemi aty edhe sigurisht do ta funksionalizojmë. Kjo është problematika sa i përket ujit te pijes. Faleminderit, nëse kemi harru edhe diçka .

z.Taulant Haxhiu: Unë drejtorit edhe pak ma herët ja bana si kërkesë. Na pe shohim qe rrjetet janë shtri po na nuk kemi shtim te kapacitetit te ujit. Unë drejtor, me fal qe po te thamë, un jam partner i koalicionit, je drejtor i financave duhet përgjigjet ti japësh. Jo gjithmonë ti jep kryetari ose nënkryetari, kur te vish ne kësi seancë te jesh me i përgatitur të lutna. Ne sipërfaqësisht po folëm asnjë pergjigje s’po ma jep kryetari ma dha e treta herë qe bëjë kërkesë asnjë përgjigje se jep sipërfaqësore. Të lutna përgatitu kur te vish ne seancë.

Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti: Nganjëherë tendenca me dhanë përgjigjen saktë për me na nxit debat kaniher pe nxitim debatin e sene, po megjithatë me mirë qe debatojmë edhe drejtori besoj qe është me mirë me i hi debatit me i sqaru gjanat po kështu e ngrite se anashkalova kisha edhe takime te ndryshe prej njana tjetrës kesh dhe me ministrin e bujqësisë sot ne takim, bisedum edhe për çështje me rendësi sa i përket sferës së bujqësisë, një takim konstruktiv qe ishte sot qe kishim ne sall atje. Për ujë te pijes, dëgjo, i kemi dy varianta. Në 1 e kemi një planifikim tonin për rritjen e kapaciteteve te ujit te pijes qe kemi pas pengesa për shkak se nuk është faktikisht baseni i ujit te pijes momentalisht i cili furnizon tërë Komunën e Vitisë, po një pjesë nuk është ne kompetenca te komunës, është ne kompetenca e “Hidromoraves”, e kemi problem juridik qe duhet me rregullu këtë marrëveshje, qe tash besoj qe edhe atë e rregullojmë ne. 1, dhe 2 e kemi fondin qe e kemi siguri, qe është për regjionin tonë, që nënkupton edhe për Vitien janë 500 deri 800 mijë euro nga banka botërore për rritjen e kapaciteteve te ujit, por unë gjithnjë këtyre projekteve të mëdhaja qe shkojnë kadale, unë e tham 100 here edhe ne mbledhjen e qeveris e kam thanë, po edhe te komiteteve, po edhe me kryesuesin kemi diskutu, që ato vijnë po vijnë ngadalë. Ne duhet me shku ma shpejt në kuptimin e asaj të përkohshmes, emergjente qe është. Ne kemi mundësi me ngrit edhe një preseku te ujit me 20 litra në sekond, i cili besoj qe qeto fshtra qe kanë mu leshu, sidomos ne pjesën qe lidhen me ujësjellësin kryesor, Smira, Verbani edhe Goshica, qe shtohen për shkak se 5 fshatna e kanë kyqjen tjetër, na mujna mi ngrit kapacitetet 20 litra ne sekond, që në mënyrë qe këta mu furnizu. Këtu duhet me punu ma shpejtë, mirëpo me lejen se tash munet me na pengu edhe donatori me lejen

domethënë edhe te donatorit edhe te kompanisë, që është me ligj e themelume, e ngrite një çështje me ransi për përkrahje. Po është, edhe sot kemi përkrahje për fermerët po ato shkojnë te ndamë. Ligji për Investime Strategjike po edhe ma parakushte edhe na si komunë.

z.Nexhat Halili: Kryetar, po e sho që ne këtë kornizën afatmesme buxhetore ka rritje. Unë ju përgëzoj që ka rritje në përgjithësi, po kam dëshirë që ta di pak një listë të projektit, nëse është lista e projekteve, duhet ta shoh atë listë.

Kryetari i komunës, z.Sokol Haliti: Unë jam i gatshëm me punu se bashku me të gjithë juve, edhe drejtorin e kemi në dispozicion, të punojmë se bashku, jemi në mesin e pesë komunave që kemi përfitu grand, kemi rritje për fatë të mirë. Urdhëroni të bëhemi së bashku grupet parlamentare, së bashku e bëjmë me të mirën për qytetarët. Vitia është e të gjithë qytetarëve, në parim të punojmë si institucion, t'i qojmë pune përpara.

Drejtori, z.Besnik Imeri: Taulant, unë besoj që ti e ke marr materialin një 10 ditë më herët edhe e ke lexu, edhe unë aty ku dal në prezantim muj me fol deri në aksham, krejt me lexu pikë, presje. Unë e lexoj kaniher, me lexu me përqindje, kaniher muj me lexu me shifra, amo ti besoj që e ke kqyr edhe e din ku jam tu than.

z.Taulant Haxhiu: Unë dola dhe thash, ti i ke zgjenu rrjetet, lokalitetet kanë rrjetet po nuk kanë kapacitet të ujit. Ti duhesh me ma dhanë një sugjerim, ti duhesh me ma dhanë një përgjigje. Ti del këtu dhe thu kjo, kjo sipërfaqësisht. Na pi teje s'marrim asnjë përgjigje decidive si drejtor i financave, asnjë përgjigje, në çoftëse këna marr ndonjë përgjigje, zotëri Nexhat, të lutena ose këta tjerët që kanë fol, kolegët e mi, në të me tregoj që kanë marr përgjigje prej teje. Unë të thash në mënyrë kolegjiale

z.Bekim Azizi: Në momente që është investimi 3.6 milion, tash perime e këna mundësi e asaj se pe she që është interesimi të çështja e ujit, që është diskutu shumë, besoj që ka me pas me diskutim, këna me mujt me i orientu sa të mujna projektet si të punojmë se bashku, si mos të punojmë së bashku na vijnë edhe mu sikur juve na vijnë propozime prej qeverisë na këna mi shtru këtu, domethënë të jemi pjesë e debateve që të mundomi m'i shti në projekte edhe me pas qasje ma shumë.

z.Ali Bajrami: Veç një sqarim në atë çka shprehi një shqetësim Nexhati, të te hyrat nga tatimi në tokë, që thotë vlera është 200 mijë euro. Mos gabofsha, përbërjen e kalume e kemi votu me kërkesë të ministrisë, që çdo vit fiskal rritet vlera 20%. Domethënë ka fillu mu implementu edhe është parapa që brena 5 viteve mrrihet vlera e 100% e pagesës të hyrave nga toka.

z.Nexhat Halili: Vlera është 256 mijë e 913 euro. Unë nuk e di që ka fillu inkasimi për tatimin në tokë.

z.Musli Neziri; Nexhat, nëse ki tokë në emër tanin, të ka ardh letra e tatimit në pronë, kështu që unë e kam pa që na ka ardh.

z.Kryesues Bekim Azizi: Unë e kisha qit në votim për miratim KAB-in. Kush është për këtë kornizë buxhetore, me ngritje të dorës? 19 prezent, 19 pro. A ka kundër, a ka abstenim? Nuk ka, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetori të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: E kemi ba na një shkresë që e ke kemi qu, mirëpo tash që kemi kryetarët e grupeve parlamentare, këtu në komision janë gjithë meshkuj. Duhet të ndryshojmë këtë.

z.Taulant Haxhiu: Kryetar, unë si shef grupi jam këtu pjesë e komisionit për shkak se nuk ka asnjë të gjinisë femërore, unë tërhekna, në vend timin është Vilsona Maliqi.

z.Ali Bajrami: Edhe unë terjekem me zëvendëson Valentina Mehmeti

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nga VV met Jakup Demiri, Reshat Azizi prej Aleancës, nga sekretaria Fatlumi, nga shoqëria civile na vjen një propozim. Plani I kuvendit, për vitin e ardhshëm behet një plan, e bim, ne seancën e ardhshme del ne diskutim publik. Ne po mendojmë edhe një punëtori me pas kuvendi para seancës qe me diskutu qet planin e punës, po zakonisht atë punëtori do ta lidhim me festen qe e kemi ne Shqipëri për shtator, fillim shtatorit qe kemi me vizitu diçka, domethënë një punëtori pune do ta bëjmë dhe do te vazhdojna. Kush është për këtë grup punues per planin e punës me ngritje te dorës? 18 prezent, 18 po, kundër s'ka, abstenim nuk ka.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2022

Kryesuesi, z.Bekim Azizi : Komunitetet kanë ba planet e punës dhe planet punës qe I kanë ba komunitetet, unë mendoj që ne do t'i miratojmë, këta e kanë parapa se janë një komunitet jo obligativ, nuk jem na qe duhet me jav ba një plan, po një plan qe e kanë paraqit këta. Nëse ka dikush qe do me diskutu për këtë plan? Nëse s'ka këta e kanë pru planin, plani ka ardh, me kohë e keni përcjell, nëse s'ka diskutime, me ngritje dore. A jeni te miratohet plani për Komitete për Shërbime Publike? 18 prezent, 18 pro.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Komuniteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e ka paraqit planin e punës. Në kuadër të këtij plani të punës nëse ka dikush me diskutu. A jeni për miratimin e planit të punës? Për janë të gjithë. A ka kundër, domethënë nuk ka, abstenim nuk ka.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore për vitin 2022

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Lindita e ka pru planin në takimin qe e ka mbajt, a jeni për miratimin e planit për komunitetin? Po, d.m.th me te gjitha votat po miratohet plani I punës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin për shqyrtimin dhe aprovimin e kodit të etikes për zyrtaret e Komunës së Vitisë

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Edhe te transparencës kërkohet edhe kodi I etikes. Kodi etikes, shumica te cilët I keni këtu është marr nga ligjet dhe udhëzimet administrative te Republikës se Kosovës dhe konsideroj se Komuna e Vitisë këtë dokument shumë te rëndësishëm është mire me pas sidomos te kodi etikes dhe njohja e shërbyesve publik, te cilët me këtë rregullore përcaktohet edhe qe domosdoshmërisht mbajtja e bexhit qe te identifikohen, te behet identifikimi I tyre, i rregullave e te gjitha sjelljeve te cilën e kemi bërë një provoj 20 vjeçare, por kadale duhet pajismi edhe me dokumente, po pse jo edhe ta kem një kod te etikes se si duhet te shihet një shërbyes civil.

z.Taulant Haxhiu: Unë si këshilltar komunal i inkuadroj këshilltarët mbikëqyrës të sektorëve të komunës, që të kenë një sjellje konform etikes, flas për veshjen për dy gjinitë, mashkullore dhe femërore, ne theks te veçantë respektimin e orarit te punës, I cili lidhet ne shërbimet ndaj qytetareve ne kohë.

z.Remzi Salihu: Nuk kam diçka te veçantë për te diskutu për kodin e etikes, përpos I kam do vërejtje, kështu të gabimet gjuhësore apo ne fjali, përshembull është zyrtarët, e tjera e tjera gjatë qe këtu qe I kam nënvizu. Unë se di kush do përmirësim muj me ja dhanë, ku është fjala te kodi etikes, disa e perceptojnë edhe veshjen, po këtu hyn edhe sjellja e nëpunësit. Kemi raste ku nëpunësi, përshembull pala kërkon një shërbim, ai nuk I drejtohet me urdhëroni çka mund të ju ndihmoj ose diçka tjetër, po hajde more prit edhe pak se a pe shehë qe e kam palën këtu. Ose boll se jam lodh, e tjera e tjera. D.m.th edhe këto janë ne kuadër te etikes. Një zyrtar palën duhet ta pres ne mënyrë shumë gjentelmene, cila do çoftë ajo palë, me apo pa arsye, se njerëzit mujn me qenë edhe te frustrum për ndonjë problem qe nuk e kanë te zgjidhur ose qe nuk e ka zgjidhur ne mënyrë te shpejtë, po duhet të ju shpjegohet se ligji e jep, se ky dokument ose kjo çështje nuk mund te kryhet ashtu siç dëshiroj unë apo dikush tjetër.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë po e thamë një, qe ne te ardhmen do ta bëjmë një standard, ata çka e punojnë me rregullore pa u kanë këtu un ka mi jek prej rendit te ditës, se nuk ka mundësi rregulloren me mbajt dikush krejt me na mbrojt nënkryetari, edhe një ka me vlejte edhe për drejtor, e bje piken ka me mbrojt piken vet, jo me ja mbrojt drejtori tjetër, po taman ta marrim perime një përgjigje dhe te jemi me serioz për punën qe jemi te ba. Drejtori e bjen piken, vimi ne kuvend, nuk është drejtori për qat pikë vetëm me naj rast qe arsyetohet krejt, përndryshe ajo pik nuk duhet me u shqyrtu, nëse s'është drejtori. Çka kemi me shqyrtu piken për financa nëse nuk është drejtori për financa. Këtë duhet ta bejna perime, kena me ba rend. Shembull te veshja, është kodi, nuk e she kravatën nuk e parasheh kravate nëse e keni lexu, po parasheh një veshje normale, qe nuk bjen ndesh me atë qe eshët për vendin e punës, me u kanë zyrtar shembull. Neni 16 e parasheh kodin e fushate. S'po thotë gjatë fushatës kandidati për kryetar komune dhe anëtarët e kuvendit. Unë mendoj qe qetu duhet me hi edhe për zgjedhje qendrore edhe për deputet, sepse mund zyrtari me kandidu për deputet aj mun me shfrytzu kod etikes duhet te jet edhe per deputet Fatlum me vjen mirë qe e prunë qeta po unë masat disiplinore kto I keni pa qka I kan paraqit po un po nderlidhna te nenit 33 pika 6 per te siguruar zbatimin e ketij kodi kuvendi I komues themelon nje komision te kodit te etikes sin je organ punues te përhershëm I kuvendit. Domethënë na po obligomi me formu si kuvend një komision. Ai komision thotë, prej dy anëtarëve te kuvendit, nja e cakton ekzekutivi. A na parasheh ligji neve, un ligj përveç qeverisjes lokale nuk kam pa qe kuvendi ka të drejtë me themelu një komision të etikes, me i përcjellë zyrtaret me qet rregullore. Na qe ta miratojna sot na pe autorizojna kuvendin me ba një komision për këtë punë, po nuk e dimë me ligj a kemi drejt parimisht na qe jemi këtu, po na pe ngarkojmë kuvendin, pe ngarkojmë veten me një komision të etikes, që nuk e di a kemi drejt ligjore. Ne nuk guxojmë me hi në diçka qe nuk e dimë a kemi drejt ligjore me ba.

z.Ali Bajrami: Te propozim vendimi, nenin 3, e kemi: për zbatimin e këtij vendimi duhet te kujdeset kryetari I komunës. Tash a po bimë na ndesh edhe na me formu një komision qe e ceke ti apo ekskluzivisht është e drejt e kryetarit si propozim qe na ka ardh prej kryetarit. Ku është roli jon atëherë aty.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë po e la qe kjo pikë te votohet ne seancën e radhës. Në të përimitohen edhe gabimet qe përmendi edhe Remzia edhe ne te shqyrtohet qekjo çështje e kuvendit. Për seancën e radhës na mbetet me votu. Këtë pikë e bijmë me votim për seancën e radhës. Kjo pik votohet për seancën e radhës.

Si pikë e tetë e rendit të ditës kemi:

8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit

Drejtor, z.Visar Demiri: Përshëndetje për te gjithë te pranishmit. Me këtë propozim vendim paraprak propozohet dhënia ne shfrytëzim e pronës se paluajtshëm te Komunës se Vitisë ,zona kadastrale në Smirë, vendi I quajtur Rashita me sipërfaqe 1834 metra katror. Afati kohor për dhënien ne shfrytëzim te pronës se

paluajtshëm komunale është afatshkurtër, me kohëzgjatje prej 5 viteve, me destinim kultura bujqësore, me qëllim të shfrytëzimit nga ana e personave fizik apo juridik. Besoj materialin e keni marr.

z.Remzi Salihu: Du të ndërlihem me kodin e etikes, pikërisht për këtë u interesova sot, isha atje të objekti I komunës dhe për konsultim të këtyre dokumenteve që janë ba disa lëshime teknike dhe aty shumë mirë më priten dhe shumë mirë I kryten punët dhe gjithçka në rregull, dhe kjo është etika. I falënderoj publikisht. Këtu është një pronë që është në shfrytëzim e sipër, që e ceku edhe kryesuesi, prandaj nuk kemi diçka të veçanti ta provojmë e ceku dikush që aj veç e paska kur del në ankan muj edhe unë me shku me apliku atje nëse I kam kushtet ma të mira muj me përfitu edhe unë jo veç aj që e ka po megjithatë kjo është mirë.

z.Taulant Haxhiu: I nderumi drejtor, prej se kemi dhënë në pronë në shfrytëzim me këtë afat shumë të shkurt 5 vjet su kanë asnjë pronë. Nuk e di pse kështu 5 vjet.

Drejtori, z.Adnan Imeri: Nëse muj një sqarim. Një ndihmesë sa me ndihmu këtë punë. Zotëri Taulant, ekziston Ligji mbi Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale, e parasheh saktë se formën dhe mënyrën se si jepen në shfrytëzim pronat komunale. E cek në një nen, që dhënia e pronës komunale jepen në 2 forma, formën afatshkurtër që është deri në 15 vite dhe në rastin e caktum drejtori e ka cek 5 vite që është komplet ligjore dhe dhënia në shfrytëzim afatgjatë, që është 99 vite, po ajo mbahet edhe me pëlqim të organeve qendrore. Për këtë arsye nuk ka diçka hapësirë me diskutu për këtë, se e ka prurë propozimin, në asamble komunale votohet, pastaj fillojnë procedurat e ankandit publik të Zyra e Prokurimit. Kaq kisha.

z.Reshat Azizi: Veç një pyetje të shkurtër kryesues: A është e precizime kjo pronë apo merr secili sa donë vet? Se mos po krijojmë një far konflikti atje, se nashta dikush e lyp komplet.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Diskutimet që I kemi ba në komitet këto pronë janë që janë kalu në listën e pronave që janë për shfrytëzim, kjo 1838 metra parcela është me e madhe po këta janë pronarët që mbjellin bahqe dhe ata kanë kërku që me pas së paku një dokument, masi janë tokë e komunës dhe dojnë që këtë pjesë me pas me dokument, këtë pjesë të shfrytëzimit me qera, që e pagun, që mos me u kanë me u indetifiku që nuk është e pronë e zantë. Faleminderit! A jeni me ngritje të dorës për kalimin tek kjo pikë e rendit të ditës? 19 janë prezent, 19 janë pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Si pikë e nëntë e rendit të ditës kemi:

9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit

Drejtori, z.Visar Demiri: Njëjtë si me parë, me këtë propozim vendim paraprak propozohet dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme e Komunës së Vitisë në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik si në vijim: në zonën kadastrale në Devajë, Komuna e Vitisë, të vendi I quajtur Visoqa, 2 parcela janë. Njëra është me sipërfaqe prej 81 m² e 412 metra katror, tjetra është me 262 m² e 76 metra katror dhe një tjetër vendi I quajtur Golesh 771 m² e 173 metra katror, afati kohorë për dhënien në shfrytëzim për pronën e paluajtshme komunale është afatshkurtër, me kohëzgjatje prej 15 vite, me destinim kultura bujqësore, me qëllim planin e shfrytëzimit të personave fizik dhe juridik.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapim diskutimin për këtë pikë.

z.Illir Zuka: Kryesues, e kemi diskutu edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, këtu është veç me caktu, domethënë kur fillon edhe me punu me shfrytëzua. Kemi pas një rast që ka kerku për shpi të pleqve, çka u kanë edhe e kemi caktu 2 vjet a 3, tash s'po më kujtohet, edhe s'ka punu kurgja. Shembull ju ka marr. Është mirë edhe këtu domethënë me cek në vendim se e diskutum edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa me ditë saktë kur fillon se ndoshta ai e merr këtë pronë edhe aj 10 vjet nuk lëvizë, mujna me ja dhanë dikujt tjetër, se ky e ka për 15 vite. Kaq s'kam ma shumë.

z.Basri Sylejmani: Unë e jap propozimin për 2 vjet, në çoftë se fillon, në çoftë se nuk fillon në t'ja marrin.

znj.Majlinda Shabani: Ku parashihet për destinimin e kulturave bujqësore, ndoshta kisha dashtë me ditë pak a shumë se çfarë kultura bujqësore parashihen se po e shoh qe për ne Smirë është për 5 vite dhe këtu është për 15 vite ndoshta ka naj ndryshim destinimi kulturave bujqësore, nëse kish bë informacion shtesë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Këshilltare, është një bashkatdhetar I joni, I cili punon në boten e jashtme, që qenka I pasionum mas këtyre çështjeve. Nuk është drejtoresha këtu, e kemi liru ne pushim, e ka ba një laburat të cilën naj ka sjell. Kryesisht do te merret me kultivimin edhe të shportarisë, po do te kalon edhe ne blegtori krejt tash aj e ka një laburim te tillë dhe aj ka provu njëherë ne viti dhe nuk e kena mirëprit, mirëpo të tregoj te drejtën dhe ka investu ne Prishtinë është hera e dytë e na ka ardh keq se u pa qe është një investitor serioz dhe kësaj radhe kemi mendu te ja krijojmë mundësinë dhe kushtet ne rast se e realizon plotësisht pajtoj me atë te cilën e thotë Iliri kufizimi, domethënë duhet te ja caktojmë startin se ku duhet ai me startu, ai me investu dy vjet ke dikush këtu unë po mendoj mrena vitit ta kufizoj kuvendi ne rast se mrena vitit fillon me investimet te cilët me ndertu gjithçka është ok, se ai I ka tani afatin 15 vjet me shfrytzu po nëse nuk asi kuvendi me pas te drejtën e rikthimit pronës aty ku është. Faleminderit!

z.Talulant Haxhiu: I nderum nënkryetar, kjo hapësirë a ju ka dhanë najherë najkujt tjetër, a ka dikush qe I keni dhanë naj afat 15 vite a është hera e par qe pe jep kuvendi.

z.Hasan Aliu, nënkryetar I komunës: Sipas informacioneve qe kam është hera e parë.

z.Ramadan Deliu: Un kisha than këta me votu menihere e po thuni perkufizime kur te del ne ankand qat her I shkrun raportet e fillimit

z.Remzi Salihu: Te kjo çështja e kufizimit te kohës e kemi pas edhe një rast ne qe I kemi dhanë po nuk është implemetu pikërisht ne Visoqe, mirëpo dihet mirëfilli se ne ankand e bënë publike komisioni mirëpo kontratën e bënë kryetari I komunës, andaj mendoj qe kryetari komunës duhet te ja caktoj afatin kushte edhe gjithë rregullat e implementimin e kësaj kontrate, nëse bahet domethënë nuk po shpresoj qe duhet te ja afatizojmë, sepse ne kontrata caktohen te gjitha këto detaje.

z.Ali Bajrami: A është e parapame me ligj qe pronat qe jepen ne shfrytëzim brenda sa kohe duhet me fillu punën, e nëse nuk fillon me ju marr prona.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kemi dhënë shumë mendime se është fjala për një parcelë, dikun 100 hektar te kemi kujdes është 100 hektar nuk është 18 ari se 18 ari edhe m'ja dhanë s'bahet name është 100 hektar 100 hektar, duhet me pas plan te mirë te biznesit edhe me ditë çka po bahet nuk guxon komuna me dhanë diçka 100 hektar edhe mos me ditë çka po bahet na edhe me Fatlumin e kemi diskutu edhe e kem pa qe na duhet këtu ta shtrojmë një nen ne këtë nen qe ti parashomi kur me fillu investime se nëse e japmi qeshtu 15 vjet, 15 vjet ajo është pronë e tina edhe na 15 vjet s'kemi qasje dhe ai mund mos me ba kurgja, e neve mrena 15 viteve munet me na ardh naj investitor shumë serioz qe ne mujm me dhanë. Unë mendoj qe ne duhet ta perkufizojmë një kohë, përshembull dy vjet qe e përmeni investimi duhet te filloj brenda viti. Unë menoj qe duhet te permenet edhe investimi mrena vitit po edhe duhet te jet një periudhë s'paku 3 vjeçare qe me u arrit një plan I biznesit.

z.Ilir Zuka: Ti e ceke jashtëzakonisht mirë, domethënë aty nuk bahet fjalë për një pronë te vogël, po bahet fjalë për 100 hektar edhe është mirë me caktu një ditë domethënë për një vjet me lan me punu përshkak se është prona jashtëzakonisht e madhe, është problem projektplanin me ba e krejt, po qëllimi është mrena dy viteve me fillu me marr formën e prerë, qe është tu punu aty. Nuk e kemi dhanë veç me nejt aty për 15 vjet me shfrytëu çka donë ai. Qekjo është ajo qe kërkova ne fillim kaq.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Propozimi jem është, brenda nenit te parashihet brenda vitit duhet te fillojnë punimet qe viti fillon prej ditës kur e merr ankand, nuk fillon prej sodit, se 6 muaj I shkojnë.

znj.Majlinda Shabani: Po besoj qe komisioni kur te formohet aty janë përfshim organizimi, planifikimi, implementimi, janë disa suaza qe besoj qe duhet me u kalu te organizimi qe përfshihet plani i punës qe shohin, plani I biznesit çka përmban konkretisht, mandej është plani I organizimit edhe implementimit. Po

besoj qe kemi me pas kohë me I diskutu. E rëndësishme për neve është me pas investime te tilla ne Komunë të Vitisë

z.Remzi Salihu: Unë mendoj që, brenda njw viti është e mjaftueshme të cekëte aty, qe nga momenti qe e fiton ankandin.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni qe te miratohet kjo pik e rendit te ditës me propozimin e Remziut, qe nga data e dhënies ne ankand, qe e merr ne shfrytëzim brenda 1 viti te filloj realizimin veprimin, a jeni për? 19 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Si pikë e dhjet e rendit të ditës kemi:

10. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin për formimin e komisioni vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës paluajtshme te komunës ne shfrytëzim. (pa shqyrtim në KPF)

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Nga ekzekutivi janë të propozuar Xhelal Shaqiri, Sebahate Metallari dhe dy përfaqësues te kuvendit edhe një nga sektori joqeveritar nga kuvendi. Nga PDK-ja propozohet Veton Ramadani, nga AAK-ja Reshat Azizi. E qes ne votim për miratim. Me 19 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Si pikë të njëmbëdhjetë të rendit të ditës kemi:

11. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimin për formimin e komisioni vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës paluajtshme te komunës ne shfrytëzim. (pa shqyrtim në KPF)

Nga ekzekutivi janë të propozuar Kushtrim Imeri, Kemajl Frangu dhe dy përfaqësues te kuvendit edhe një nga sektori jo qeveritar. Nga kuvendi nga LDK-ja propozohet Zejnepe Osmani, nga LVV-ja Durim Sylejmani. Qes ne votim për miratim. Me 19 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Si pike të dymbëdhjetë të rendit të ditës kemi:

12. Propozim vendim për furnizim me pajisje me lloptop për këshilltarët e kuvendit komunal dhe sekretarin e kuvendit

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Duke pasu parasysh qe mjetet I kemi dhe volumin e punës në sekretarinë kuvendit me material, jemi konsultu edhe me komunat tjera, para juve e keni propozim vendimin. Nëse ka për debat hapi debat, nëse jo, qes ne votim për miratim. Me 19 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi:Ju faleminderit për kontributin e dhënë në këtë seancë, shihem në mbledhjet tjera. Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:00 min.

**Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi**
